



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 95

Tiranë – E enjte, 4 maj 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 48/2017 datë 13.4.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit të konkurrueshmërisë..... 5333
Ligj nr. 49/2017 datë 13.4.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes Istisna'a dhe të marrëveshjes së agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për financimin shtesë për projektin e rrugës Tiranë - Elbasan..... 5339
Ligj nr. 50/2017 datë 13.4.2017	Për miratimin e rezolutës nr. Bg/6-434, “Në lidhje me rritjen e përgjithshme të 5-të të kapitalit të Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) dhe arkëtimin e 50 për qind (pjesa e arkëtueshme e parave) të kapitalit të nënshkruar të Bankës Islamike për Zhvillim, sipas rritjes së 4-t të përgjithshme të kapitalit dhe disa nënshkrimeve të tjera të veçanta”, të vitit 2013, të Bordit të Guvernatorëve të Bankës Islamike për Zhvillim..... 5356
Ligj nr. 52/2017 datë 13.4.2017	Për ratifikimin e ndryshimit nr. 1 të marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA) nën Fondin Suedeze të Besimit, për Fondin e Besimit nr. TF 072239, për projektin e shërbimeve mjedisore në Shqipëri, të ratifikuar me ligjin nr.64/2015..... 5362
Ligj nr. 54/2017 datë 13.4.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar..... 5364



LIGJ
Nr. 48/2017

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË
HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM PËR HUAN E
POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË
KONKURRUESHMËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit të konkurrueshmërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.4.2017

**Shpallur me dekreten nr. 10218, datë 27.4.2017
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Departamenti Ligjor
TEKST I NEGOCIUAR
(Objekt ndryshimi)
Luz Meza-Bartrina
5 dhjetor 2016

HUA NR. 8689-AL

MARRËVESHJE HUAJE
(HUA PËR POLITIKËN E ZHVILLIMIT
TË KONKURRUESHMËRISË) NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
Datë _____, 201__

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshje datë _____, 201__, e lidhur ndërmjet REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (“Huamarrësi”) dhe BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (“Banka”) me qëllim vënien në dispozicion të financimit në mbështetje të Programit (siç përkufizohet në Shtojcën e kësaj Marrëveshjeje). Banka ka vendosur ta japë këtë financim, ndër të tjera në bazë të i) masave që ka marrë tashmë Huamarrësi në kuadër të Programit dhe të cilat përshkruhen në seksionin I, shkronja “A” të Lidhjes 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe ii) ruajtjes nga Huamarrësi të një kuadri politikash makroekonomike të përshtatshme. Përmes kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni I

Kushtet e përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç përkufizohen në Shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Nëse nuk e kërkon ndryshe konteksti, termat që fillojnë me shkronjë të madhe në këtë Marrëveshje kanë kuptimin e vendosur për to në Kushtet e Përgjithshme ose në Shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Huaja

2.01 Banka bie dakord t’i japë hua Huamarrësit, sipas kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, shumën prej 65.800.000 milion Euro (gjashtëdhjetë e pesë milion e tetëqind mijë Euro) (“Huaja”).

2.02 Huamarrësi mund t’i tërheqë fondet e Huasë në mbështetje të Programit sipas seksionit II të Lidhjes 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa e pagueshme në fillim nga Huamarrësi është sa një e katërta e një për qind (0,25%) e shumës së Huasë.

2.04 Tarifa e Angazhimit e pagueshme nga Huamarrësi është sa një e katërta e një për qind (0,25%) në vit e shumës së Tepricës së Patërhequr të Huasë.

2.05 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo Periudhë Interesi është me një normë sa Norma e Referimit për Monedhën e Huasë plus një



Marzh të Pandryshueshëm; por me kusht që interesi i pagueshëm të mos jetë asnjëherë më pak se zero për qind (0%) në vit. Pavarësisht nga sa më lart, nëse shuma e Tepricës së Tërhequr e Huasë mbetet e pashlyer përtej afatit dhe nëse një mosshlyerje e tillë vijon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, atëherë interesi i pagueshëm nga Huamarrësi llogaritet siç parashikohet në seksionin 3.02, shkronja “e”, të Kushteve të Përgjithshme.

2.06 Datat e Shlyerjes janë 1 mars dhe 1 shtator, të çdo viti.

2.07 Principali i Huasë duhet të shlyhet sipas tabelës së amortizimit që jepet në Lidhjen 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.08 Pa kufizuar dispozitat e seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme (rinumërtuar në bazë të pikës 5 të seksionit II të Shtojcës së kësaj Marrëveshjeje dhe të lidhura me *Bashkëpunimin dhe Konsultimin*), Huamarrësi i jep menjëherë Bankës informacionet e lidhura me dispozitat e këtij neni II sipas kërkesave të arsyeshme e të herëpashershme të Bankës.

Neni III Programi

3.01. Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për Programin dhe zbatimin e Programit. Për këtë qëllim dhe krahas seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme:

a. Huamarrësi dhe Banka, herë pas here, me kërkesën e secilës palë, shkëmbejnë pikëpamje për kuadrin e politikave makroekonomike të Huamarrësit dhe për progresin e arritur në realizimin e Programit;

b. përpara çdo shkëmbimi të tillë pikëpamjesh, Huamarrësi i jep Bankës, për shqyrtim dhe komente nga ana e saj, një raport për progresin e arritur në realizimin e Programit, me nivel hollësie siç mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme Banka; dhe

c. pa kufizuar dispozitat e shkronjave “a” dhe “b” të këtij neni, Huamarrësi e informon menjëherë Bankën për çdo situatë që do të kishte për pasojë ndryshimin nga pikëpamja materiale të objektivave të Programit ose për çdo masë të marrë në bazë të Programit, duke përfshirë edhe masat e përcaktuara në seksionin I të Lidhjes 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV

Mjetet ligjore të bankës

4.01 Ngjarja Shtesë e Pezullimit konsiston në rastin kur ka lindur një situatë e cila e bën të pamundur realizimin e Programit ose të një pjese të konsiderueshme të tij.

Neni V

Hyrja në fuqi; zgjidhja

5.01 Kushti Shtesë i Hyrjes në Fuqi konsiston në faktin që Banka të jetë e kënaqur me progresin e arritur nga Huamarrësi në realizimin e Programit dhe me nivelin e mjaftueshëm të kuadrin të politikave makroekonomike të Huamarrësit.

5.02 Afati për Hyrjen në Fuqi është data 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni VI

Përfaqësuesi; adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave i tij.

6.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit, Nr. 3
Tiranë, Shqipëri

Faks:

355 42228494

6.03 Adresa e Bankës është:

International Bank for Reconstruction and Development

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Teleks:

Faks:

248423(MCI) or

1-202-477-6391

64145(MCI)

LIDHUR në _____, _____, më
ditën dhe vitin e shkruar në krye.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

**BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Nga

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Lidhja 1**Masat e Programit; Gatishmëria e fondeve të Huasë****Seksioni I. Masat në bazë të Programit****A. Masat e marra në bazë të Programit.**

Masat e marra nga Huamarrësi në bazë të Programit përfshijnë sa më poshtë:

1. Miratimi i një deklarate të politikës për investimet ku përshkruhet angazhimi dhe plani i veprimit i Huamarrësit për të përgatitur një ligj të gjithanshëm për investimet i cili të jetë në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare, siç dëshmohet nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 579 “Për miratimin e udhërrëfyesit të politikës së investimeve të Qeverisë Shqiptare” miratuar më 3 gusht 2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 153, datë 12.8.2016.

2. Miratimi i masave për krijimin e sekretariatit për trajtimin e ankesave të investitorëve, siç dëshmohet nga Urdhri i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 6299 “Për masat e nevojshme për krijimin e mekanizmit të trajtimit të ankesave të investitorëve pranë AIDA-s” nxjerrë më 3 gusht 2016.

3. Miratimi i një vendimi për rregullimin e territorit dhe ndërtimet ku të përshkruhen udhëzimet për procesin e lejeve të reja të ndërtimit dhe ku të miratohet për përdorim platforma e re online për dhënien e lejeve të ndërtimit, siç dëshmohet nga Letra e datës 10 shkurt 2016 (Nr. Prot. 780/1) që Ministri i Zhvillimit Urban u dërgon të gjitha bashkive në territorin e Huamarrësit dhe palëve të tjera të interesit në sektorin e ndërtimit.

4. Miratimi i lidhjeve të reja me sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, siç dëshmohet nga Vendimi Nr. 166 “Për miratimin e “Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, të nxjerrë nga ERE më 10.10.2016, botuar në faqen në internet të ERE-s http://ere.gov.al/doc/VENDIMno.166_2016.pdf.

5. Miratimi i ligjit që bashkon në një institucion Qendrën e Regjistrimit të Biznesit dhe Qendrën Kombëtare të Licencimit, siç dëshmohet nga Ligji nr. 131/2015, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 131, datë 26.11.2015.

6. (i) krijimi i Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut, siç dëshmohet nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.36, datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 10, datë 1.2.2016; dhe (ii) miratimi i strukturës organizative të Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut, siç dëshmohet nga Urdhri i Kryeministrit nr. 86, datë 16.5.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”.

7. Miratimi i një politike për menaxhimin e riskut dhe ristrukturimi i njësive të menaxhimit të riskut pranë AKU-së, siç dëshmohet nga politika e menaxhimit të riskut, miratuar nga AKU në maj 2016.

8. Miratimi i udhëzimit për zhdoganimin lokal ku përfshihen praktikat më të mira dhe qartësohen: a) kriteret e lidhura me dhënien e autorizimit të zhdoganimit lokal; b) veprimet procedurale që duhen kryer që nga momenti i mbërritjes së mallrave në kufi deri në nxjerrjen në qarkullim të lirë të tyre; dhe c) detyrimet e operatorit ekonomik, siç dëshmohet nga Udhëzimi nr. 10564, nxjerrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, datë 22.4.2016 “Lidhur me procedurat e thjeshtuara, zhdoganimin në ambientet e operatorit ekonomik”.

9. Ulja e numrit të ditëve të lira të magazinimit të mallrave në Portin e Durrësit përmes ndryshimit të rregulloreve të portit, siç dëshmohet nga rregullorja e magazinimit nr. 1568, datë 14.7.2015, nxjerrë si Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrit të Financave më 16 shtator 2015, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 162 të vitit 2015.

Seksioni II. Gatishmëria e fondeve të Huasë

A. Të përgjithshme. Huamarrësi mund t'i tërheqë fondet e Huasë në përputhje me dispozitat e këtij seksioni dhe me udhëzime të tjera shtesë që mund t'i njoftojë Banka Huamarrësit.

B. Shpërndarja e shumave të Huasë. Huaja (me përjashtim të shumave të nevojshme për të paguar tarifën e pagueshme në fillim) shpërndahet në një transh të vetëm për tërheqje, nga i cili Huamarrësi mund të bëjë tërheqje të fondeve të



Huasë. Shpërndarja e shumave të Huasë për këtë qëllim përcaktohet në tabelën në vijim:

Shpërndarjet	Shuma e Huasë e shpërndarë (shprehur në euro)
(1) Transh i vetëm për tërheqje	65.635.500
(2) Tarifa e pagueshme në fillim	164.500
SHUMA GJITHSEJ	65.800.000

C. Kushtet për çlirimin e transhit për tërheqje.

Nga Transhi i vetëm për tërheqje nuk bëhet asnjë tërheqje nëse Banka nuk është e kënaqur a) me realizimin e Programit nga Huamarrësi dhe b) me nivelin adekuat të kuadrit të politikave makroekonomike të Huamarrësit.

D. Derdhjet e shumave të Huasë. Nëse Banka nuk bie dakord ndryshe:

1. Të gjitha shumat e tërhequra nga Llogaria e Huasë Banka i derdh në një llogari të përcaktuar nga Huamarrësi dhe të pranueshme për Bankën; dhe

2. Huamarrësi siguron që me çdo derdhje të një shume të Huasë në këtë llogari, një shumë e barasvlershme të kontabilizohet në sistemin e menaxhimit të buxhetit të Huamarrësit, në një mënyrë që të jetë e pranueshme për Bankën.

E. Shpenzimet e përjashtuara. Huamarrësi premton që fondet e Huasë nuk do të përdoren për të financuar Shpenzime të Përjashtuara. Nëse Banka konstaton në çdo moment se një shumë e Huasë është përdorur për të paguar një Shpenzim të Përjashtuar, Huamarrësi, me të marrë njoftim nga Banka, i kthen menjëherë Bankës një shumë të barasvlershme me një pagesë të tillë. Shumat që i kthehen Bankës me kërkesë të tillë anulohen.

F. Data e Mbylljes. Data e Mbylljes është data 31 janar 2018.

Lidhja 2 Tabela e amortizimit

1. Në tabelën në vijim jepen datat e shlyerjes së Principalit të Huasë dhe përqindja e shumës gjithsej të Principalit të Huasë të pagueshme më çdo datë shlyerjeje të Principalit (“Përqindja e Këstit”). Nëse fondet e Huasë janë tërhequr plotësisht deri më datën e parë të shlyerjes së Principalit, shumat e principalit të Huasë që duhet të shlyejë Huamarrësi më çdo datë shlyerjeje të Principalit përcaktohet

nga Banka duke shumëzuar: a) Tepricën e Huasë së tërhequr deri më datën e parë të shlyerjes së Principalit; me b) Përqindjen e Këstit për çdo datë të shlyerjes së Principalit.

Data e shlyerjes së Principalit	Përqindja e Këstit (shprehur si përqindje)
Më 1 mars dhe 1 shtator çdo vit Duke filluar më 1 mars 2022 deri më 1 mars 2037, duke e përfshirë edhe këtë datë	3,13%
Më 1 shtator 2037	2,97%

2. Nëse fondet e Huasë nuk janë tërhequr plotësisht deri më datën e parë të shlyerjes së Principalit, shumat e principalit të Huasë që duhet të shlyejë Huamarrësi më çdo datë shlyerjeje të Principalit përcaktohet si vijon:

a. Për atë sa janë tërhequr fondet e Huasë deri më datën e parë të shlyerjes së Principalit, Huamarrësi shlyen Tepricën e Huasë së tërhequr deri më këtë datë në përputhje me pikën 1 të kësaj Lidhjeje.

b. Çdo shumë e tërhequr pas datës së parë të shlyerjes së Principalit duhet të shlyhet më çdo datë të shlyerjes së Principalit që bie pas datës së një tërheqjeje të tillë, me një shumë që e përcakton Banka duke shumëzuar shumën e çdo tërheqjeje të tillë me një thyesë, numëruesi i së cilës është Përqindja fillestare e Këstit e përcaktuar në pikën 1 të kësaj Lidhjeje për datën në fjalë të shlyerjes së Principalit (“Përqindja Fillestare e Këstit”) dhe emëruesi i së cilës është shumat e të gjitha Përqindjeve Fillestare të Këstit të mbetura për datat e shlyerjes së Principalit që bien më këtë datë ose pas kësaj date.

3.a Shumat e Huasë të tërhequra brenda dy muajve kalendarikë përpara çdo date të shlyerjes së Principalit trajtohen, vetëm në funksion të llogaritjes së shumave të principalit të pagueshme më çdo datë të shlyerjes së Principalit, si të tërhequra dhe të pagueshme më datën e dytë të shlyerjes së Principalit që bie pas datës së tërheqjes dhe duhet të shlyhen më çdo datë të shlyerjes së Principalit që fillojnë pas datës së dytë të shlyerjes së Principalit pas datës së tërheqjes.

b. Pavarësisht nga dispozitat e shkronjës “a” të kësaj pike, nëse, në çfarëdo momenti, Banka fut në përdorim një sistem të faturimit me datë shlyerjeje në të cilin faturat lëshohen më ose pas datës përkatëse të shlyerjes së Principalit, dispozitat e



lartpërmendura nuk zbatohen më për tërheqjet e bëra pas futjes në përdorim të një sistemi të tillë faturimi.

SHTOJCË

Seksioni I. Përkufizime

1. “AIDA” është Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve e krijuar në bazë të Ligjit nr. 10303 botuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 11.8.2010.

2. “ERE” është Autoriteti Rregullator Shqiptar i Energjisë i krijuar në bazë të Ligjit nr. 43/2015 datë 30.4.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87, datë 28.5.2015 dhe Ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 114, datë 22.7.2008.

3. “Shpenzime të përjashtuara” janë çdo shpenzim:

a. për mallra ose shërbime të furnizuara në bazë të një kontrate që një institucion ose agjenci kombëtare ose ndërkombëtare financimi që nuk është Banka ose Shoqata e financon ose ka rënë dakord t'i financojë, ose të cilën Banka ose Shoqata i financon ose ka rënë dakord t'i financojë në kuadër të një tjetër huaje, kredie ose granti;

b. për mallra të përfshira në grupet ose nëngrupet e mëposhtme të Klasifikimit Tregtar Ndërkombëtar Standard, Rishikimi 3 (SITC, Rev.3), botuar nga OKB në Materialet Statistikore, Seria M, Nr. 34/Rev.3 (1986) (“SITC”), ose në çdo grup ose nëngrup zëvendësues të futur me rishikimet e ardhshme të SITC-së, të cilat Banka ia njofton Huamarrësit:

Grupi	Nëngrupi	Përshkrimi i artikullit
112		Pije alkoolike
121		Duhan, jo i kaluar në prodhim, duhan mbetje
122		Duhan, i kaluar në prodhim (pavarësisht nëse përmban ose jo zëvendësues të duhanit)
525		Lëndë radioaktive dhe lëndë të lidhura
667		Perla, gurë të çmuar dhe gjysmë të çmuar, të përpunuar ose jo të përpunuar
718	718.7	Reaktorë bërthamorë dhe pjesë të tyre; elemente të lëndëve djegëse (fishekë), jo të rrezatuara, për reaktorët bërthamorë
728	728.43	Makineri për përpunimin e duhanit
897	897.3	Bizhuteri me metale të grupit të arit, argjendit ose platinut (me përjashtim të orëve dhe kasave të orëve) dhe mallrat e arpunuesve dhe argjendpunuesve (përfshirë edhe gurët e vendosur në to)
971		Ari, jo monetar (pa përfshirë xehërorët dhe koncentratet e arit)

c. për mallrat e synuara për përdorim ushtarak ose paraushtarak ose për konsum luksi;

d. për mallrat e rrezikshme për mjedisin, prodhimi, përdorimi ose importimi i të cilave është i ndaluar nga ligjet e Huamarrësit ose nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat është palë Huamarrësi);

e. për llogari të një pagese të ndaluar me vendim të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të marrë në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara; dhe

f. në lidhje me të cilat Banka konstaton se përfaqësues të Huamarrësit ose të marrësit të fondeve të Huasë janë përfshirë në praktika korruptuese, mashtruese, shantazhi apo kërcënuese, për të cilat Huamarrësi (ose marrësi i fondeve të Huasë) nuk ka vepruar në kohë dhe siç

duhet në mënyrë të kënaqshme për Bankën, për t'u dhënë zgjidhje praktikave të tilla.

4. “Kushtet e përgjithshme” janë “Kushtet e Përgjithshme për Huatë të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim”, të datës 12 mars 2012, me ndryshimet e parashikuara në Seksionin II të kësaj Shtojce.

5. “AKU” është Agjencia Kombëtare e Ushqimit, agjencia e Huamarrësit për kontrollin mbikëqyrës të ushqimit, krijuar në bazë të Ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, i ndryshuar deri më 28 janar 2008.

6. “Programi” është: a) programi me masat, objektivat dhe politikat e hartuara për të nxitur rritjen dhe për të arritur ulje të qëndrueshme të varfërisë, që parashikohet ose përmendet në letrën e datës 6 dhjetor 2016 që Huamarrësi i ka dërguar Bankës për të deklaruar angazhimin e Huamarrësit



për ekzekutimin e Programit dhe për të kërkuar asistencën e Bankës në mbështetje të Programit gjatë ekzekutimit të tij; si edhe, ose përfshirë, b) masat e parashikuara në Seksionin I të Lidhjes 1 të kësaj Marrëveshjeje.

7. “Transhi i vetëm për tërheqje” është shuma e Huasë e shpërndarë për kategorinë me titull “Transhi i vetëm për tërheqje” në tabelën që jepet në Pjesën B të seksionit II të Lidhjes 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni II. Ndryshime në Kushtet e Përgjithshme

Përmes këtij seksioni bëhet ndryshimet e mëposhtme në Kushtet e Përgjithshme:

1. Në Tabelën e Përmbajtjes, seksionet, titujt e seksioneve dhe numrat e seksioneve ndryshohen për të pasqyruar ndryshimet e parashikuara në pikat e mëposhtme.

2. Fjalja e fundit e shkronjës “a” të seksionit 2.03 (lidhur me Kërkesën për tërheqje) hiqet si e tërë.

3. Seksionet 2.04 (*Llogaritë e përcaktuara*) dhe 2.05 (*Shpenzimet e lejuara*) hiqen në tërësi dhe pjesa e mbetur e seksioneve të nenit II rinumërtohen për të pasqyruar këto ndryshime.

4. Seksioni 3.01 (*Tarifa e pagueshme në fillim*) ndryshon dhe ka përmbajtjen e mëposhtme:

“Seksioni 3.01. *Tarifa e pagueshme në fillim; Tarifa e Angazhimit*

a) Huamarrësi i paguan Bankës një tarifë të pagueshme në fillim mbi shumën e huasë me normën e përcaktuar në Marrëveshjen e Huasë (“Tarifa e pagueshme në fillim”).

b) Huamarrësi i paguan Bankës një tarifë angazhimi mbi Tepricën e shumës jo të tërhequr të Huasë me normën e përcaktuar në Marrëveshjen e Huasë (“Tarifa e angazhimit”). Tarifa e angazhimit konstatohet duke filluar datën që bie gjashtëdhjetë ditë pas datës së Marrëveshjes së Huasë deri në datat kur shumat tërhiqen nga Huamarrësi nga Llogaria e Huasë ose kur shumat anulohen. Tarifa e angazhimit është e pagueshme çdo gjashtë muaj në fund të periudhës më çdo Datë shlyerjeje.”

5. Seksionet 5.01 (*Realizimi i Projektit në përgjithësi*) dhe 5.09 (*Drejtimi financiar; Pasqyrat Financiare; Auditimet*) hiqen në tërësi dhe seksionet e mëposhtme në nenin V rinumërtohen për të pasqyruar këtë ndryshim.

6. Shkronja “a” e Seksionit 5.05 (rinumërtuar kështu në bazë të pikës 5 më lart në lidhje me

Përdorimin e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve) hiqet në tërësinë e vet.

7. Shkronja “c” e seksionit 5.06 (rinumërtuar kështu në bazë të pikës 5 më lart) ndryshohet si vijon:

“Seksioni 5.06. *Planet; Dokumentet; Evidencat*

... c. Huamarrësi ruan të gjitha evidencat (kontrata, urdhra, fatura, preventivë, mandate dhe dokumente të tjera) që dëshmojnë shpenzimet në kuadër të Huasë deri dy vjet pas Datës së Mbylljes. Huamarrësi u mundëson përfaqësuesve të Bankës t’i këqyrin këto evidenca.”

8. Shkronja “c” e seksionit 5.07 (rinumërtuar kështu në bazë të pikës 5 më lart) ndryshohet si vijon:

“Seksioni 5.07. *Monitorimi dhe vlerësimi i Programit*

... c. Huamarrësi përgatit, ose siguron që të përgatitet, dhe i vë në dispozicion Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas Datës së Mbylljes, një raport me objekt dhe nivel hollësie siç e kërkon në mënyrë të arsyeshme Banka, për realizimin e Programit, përmbushjen nga Palët e Huasë dhe Banka të detyrimeve përkatëse të tyre në bazë të marrëveshjeve ligjore dhe përmbushjen e qëllimeve të Huasë.”

9. Në Shtojcë, Përkufizimet, të gjitha referimet e numrave të seksioneve dhe pikave ndryshohen për të pasqyruar ndryshimet e parashikuara në pikat e mësipërme.

10. Shtojca ndryshohet dhe në të shtohet një pikë e re, pika 19, me përkufizimin e mëposhtëm të “Tarifës së angazhimit”, duke rinumërtuar pikat e mbetura për të pasqyruar këtë ndryshim:

“19. “Tarifa e angazhimit” është tarifa e angazhimit e përcaktuar në Marrëveshjen e Huasë në kuptim të seksionit 3.01, shkronja “b”).”

11. Pika 37 e rinumërtuar (më parë, pika 36) e Shtojcës (“Shpenzimet e lejuara”) ndryshohet si vijon:

“37. “Shpenzim i lejuar” është çdo përdorim për të cilin jepet Huaja në mbështetje të Programit, që nuk përfshin shpenzimet e financimit të përjashtuara në bazë të Marrëveshjes së Huasë.”

12. Pika 44 e rinumërtuar (më parë, pika 43) e Shtojcës (“Pasqyrat financiare”) hiqet si e tërë.

13. Në pikën 48 të Shtojcës, përkufizimi i “Tarifës të pagueshme në fillim” ndryshon për të zëvendësuar fjalët “seksioni 3.01” me fjalët “seksioni 3.01, shkronja “a”).”



14. Në pikën 67 të Shtojcës, përkufizimi i termit “Shlyerja e huasë” ndryshon si vijon:

“67. “Shlyerja e huasë” është çdo shumë e pagueshme nga Palët e Huasë kundrejt Bankës në bazë të marrëveshjeve ligjore ose të këtyre Kushteve të Përgjithshme, përfshirë (ndër të tjera) çdo shumë të Tepricës së tërhequr të Huasë, interesat, Tarifën e pagueshme në fillim, Tarifën e angazhimit, kamatëvonesën sipas normës së kamatëvonesës (nëse ka), çdo sanksion të shlyerjes përpara kohe, çdo tarifë transaksioni për një Konvertim ose zgjidhje përpara afatit të një Konvertimi, Tarifë për vendosjen e marzhit të ndryshueshëm (nëse ka), çdo sanksion të pagueshëm për vendosjen e një Tavani mbi normën e interesit ose për të vendosur Normë interesi zero dhe çdo shumë likuidimi të pagueshme nga Huamarrësi.”

15. Në pikën 72 të Shtojcës, përkufizimi i “Datës së shlyerjes” ndryshon duke hequr fjalën “është” dhe duke futur fjalët “dhe Tarifa e angazhimit janë” pas fjalës “interesi”.

16. Në përkufizimit e termit “Projekti”, kjo fjalë zëvendësohet me fjalën “Programi” dhe i gjithë përkufizimi ndryshon si vijon (ku sa herë është përmendur fjala “Projekti” kjo konsiderohet se i referohet “Programit”):

“75. “Programi” është programi i përmendur në Marrëveshjen e Huasë në mbështetje të të cilit jepet Huaja.”

LIGJ

Nr. 49/2017

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ISTISNA'A DHE TË MARRËVESHJES SË AGJENCISË ISTISNA'A NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR FINANCIMIN SHITESË PËR PROJEKTIN E RRUGËS TIRANË - ELBASAN

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja Istisna'a dhe marrëveshja e agjencisë Istisna'a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për financimin shitesë për projektin e rrugës Tiranë-Elbasan, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 13.4.2017

Shpallur me dekretin nr. 10219, datë 27.4.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Projekti Nr. 2ALB0033.1

MARRËVESHJA ISTISNA'A (FINANCIM SHITESË)

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E RRUGËS TIRANË-ELBASAN

MARRËVESHJA ISTISNA'A

Kjo marrëveshje lidhet në datën ___/___/1437H (që i korrespondon ___/___/2016G) ndërmjet KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (e referuar më poshtë si “Blerësi”) dhe BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (e referuar më poshtë si “Shitësi” ose “IDB”).

Blerësi dhe Shitësi referohen më poshtë individualisht si “Palë” dhe bashkërisht si “Palët”.



Duke patur parasysh se:

A. Blerësi i ka kërkuar Bankës që të marrë pjesë në financimin e punimeve të ndërtimit për Projektin e Rrugës Tiranë-Elbasan, Shqipëri, siç përshkruhen në Aneksin-II (referuar më poshtë si “Projekti”).

B. Banka në datën 23/03/1432|H (që i korrespondon 26/02/2011|G) ka miratuar financimin e projektit nëpërmjet “Istisna’a” për një shumë, e cila nuk i kalon USD 222,700,000 (Dyqind e Njëzet e Dy Milionë e Shtatëqind Mijë Dollarë Amerikanë) Një Marrëveshje Istisna’a që reflekton sa më sipër është nënshkruar nga Palët më 07/04/2011G dhe ka hyrë në fuqi në datën 06/07/2011G.

C. Për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme që kanë rezultuar gjatë zbatimit të Projektit, Blerësi i ka drejtuar një kërkesë zyrtare Bankës më datën 30/03/2016/G për një rritje në Shumën Fillestare të Financimit me qëllim ndërtimin e asetit siç përshkruhet në Aneksin-I (referuar më poshtë si “Aseti”).

D. Banka në datën 20/10/1437H (që i korrespondon 25/07/2016G) ka miratuar financimin shtesë të Punimeve nëpërmjet Istisna’a për një shumë që nuk i kalon USD 35,174,256.80 ((Dollarë Amerikanë – Tridhjetë e Pesë Milionë e Njëqind e Shtatëdhjetë e Katër Mijë e Dyqind e Pesëdhjetë e Gjashtë e Tetëdhjetë Centë) (e referuar më poshtë si “Shuma e Financimit”); dhe shitjen e Punëve të Blerësi në përputhje me kushtet dhe afatet që përcaktohen në Nenin 4 të Marrëveshjes.

E. Sipas kësaj Marrëveshjeje, marrëdhënia ndërmjet Bankës dhe Blerësit është ajo ndërmjet shitësit dhe blerësit në përputhje me parimet e Sherihatit, siç interpretohen nga Akademia Islamike Fiqh dhe siç parashtrohet në Standardet e Sherihatit publikuar nga Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit për Institucionet Financiare Islamike (AAOIFI).

Rrjedhimisht, Shitësi dhe Blerësi bien dakord për sa vijon:

Seksioni - 1 Përkufizime – Interpretimi

1.1 Në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat që vijojnë do të kenë kuptimin që jepet përbri secilës prej tyre këtu më poshtë:

Marrëveshja e Agjencisë: Marrëveshja e të njëjtës datë ndërmjet Shitësit dhe Blerësit ku Blerësi

do të veprojë si agjent i Shitësit në përzgjedhjen e Kontraktuesit dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Asetit.

Kostoja Kapitale: Kostoja totale e realizimit të Asetit, e cila do të përfshijë Çmimin e Kontratës, tarifat e Konsulentit dhe të gjitha kostot ose shpenzimet e tjera të kryera nga IDB në ose në lidhje me realizimin e Punimeve të Ndërtimit dhe mbikëqyrjen e ndërtimeve.

Kontrata: Kontrata për realizimin e Punimeve të Ndërtimit, e cila është lidhur nga Blerësi me Kontraktuesin në emër dhe me miratimin e Shitësit.

Kontraktuesi: Kontraktuesi të cilit do t'i besohet realizimi i Asetit.

Konsulenti: Konsulenti të cilit do t'i besohet projektimi, mbikëqyrja (mbikëqyrja inxhinierike) dhe koordinimi i Punimeve që do të kryhen sipas Kontratës, siç jepet në Marrëveshjen e Konsulencës.

Marrëveshja e Konsulencës: Marrëveshja me Konsulentin për ofrimin e shërbimeve të konsulencës që i përkasin Asetit që do të lidhet nga Blerësi në emër të Shitësit.

Çertifikata Përfundimtare e Pranimit:

Çertifikata e lëshuar nga Konsulenti në përputhje me kushtet e Kontratës, e cila përcakton se realizimi i Asetit është kryer në mënyrë të pranueshme nga Kontraktuesi. Çertifikata duhet të nënshkruhet gjithashtu edhe nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Disbursimi i Parë: Pagesa e parë në vijim të hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me politikat dhe udhëzimet përkatëse të IDB-së.

Periodha e Realizimit: Periodha që fillon nga Data e Disbursimit të Parë dhe përfundon 36 (Tridhjetë e Gjashtë) muaj më pas.

Projekti: Projekti i përshkruar në Aneksin II këtu.

Bankat e Referencës: Zyrrat qendrore në Londër të JPMorgan Chase, Citibank N.A. dhe HSBC dhe/ose çdo bankë tjetër e caktuar nga Shitësi që zëvendëson secilën prej bankave paraprëse;

Çmimi i Shitjes: Çmimi i Shitjes së Asetit që paguhet nga Blerësi tek Shitësi në përputhje me Seksionin IX këtu.

Taksa: Të gjitha taksat, detyrimet, tatimet ose pagesa të tjera të natyrës së ngjashme (duke përfshirë pa kufizim çdo penalitet të pagueshëm në



lidhje me çdo mospagesë ose vonesë në pagesën e tyre).

US\$ LIBOR: Në lidhje me një periudhë të caktuar, mesatarja aritmetike (e rrumbullakosur nëse është e nevojshme deri në pesë numra pas presjes dhjetore) e Normave të Ofruara të London Interbank për depozitat në Dollarë për atë periudhë ose rreth orës 11.00 paradite (ora e Londrës) Në Ditën e dytë të Punës përpara ditës së parë të asaj periudhe, siç jepet në faqen 01 LIBOR të Shërbimit Reuter Monitor Money Rates (ose çdo faqe tjetër që mund të zëvendësojë këtë faqe LIBOR në një shërbim të tillë për qëllimin e paraqitjes së Normave të Ofruara të London Interbank të bankave kryesore për depozitat në Dollarë) me kusht që nëse në një datë të tillë normat e ofruara të më pak sesa dy bankave zëvendësohen, LIBOR për atë periudhë do të jetë mesatarja aritmetike (e rrumbullakosur siç u përmend më parë) e normave të cituara përkatësisht për Shitësin nga secila prej Bankave të Referencës me kërkesën e Shitësit si norma e ofruar e Bankave të Referencës për depozitat në Dollarë në një shumë afërsisht të barabartë me shumën në lidhje me të cilën do të përcaktohet LIBOR për një periudhë ekuivalente me atë periudhë me bankat kryesore në Tregun e London Interbank në orën 11.00 paradite ose përrreth kësaj ore (ora e Londrës) në Ditën e Dytë të Punës përpara ditës së parë të asaj periudhe;

Dollarë: Monedha ligjore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Amerikanë dhe US\$:

Përqindja US\$ SWAP: Përqindja e caktuar në Reuter Screens USDSFIX= një ditë pune përpara datës së Disbursimit të parë.

Punime: Punimet e përshkruara në Aneksin - I këtu.

1.2 Në këtë Marrëveshje:

a) Përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe, fjalët që tregojnë numrin njëjës përfshijnë edhe numrin shumës dhe anasjelltas, fjalët që tregojnë persona përfshijnë korporata dhe partneritete; dhe referenca ndaj një Aneksi, Shtojce ose Seksioni të specifikuar është një reference ndaj atij Aneksi, Shtojce, Seksioni të kësaj Marrëveshjeje.

b) Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e Agjencisë dhe që nuk janë përcaktuar këtu do të kenë të njëjtin kuptim siç jepet në Marrëveshjen e Agjencisë.

c) Titujt e Seksionit përfshihen vetëm për lehtësi reference dhe nuk do të shfrytëzohen për të përkufizuar, interpretuar ose kufizuar asnjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni - 2 Hyrja dhe anekset pjesë e marrëveshjes

Hyrja dhe Anekset e kësaj Marrëveshjeje do të jenë pjesë integrale e saj.

Seksioni – 3 Realizimi i asetit

3.1 Shitësi bie dakord që punimet e ndërtimit të realizohen në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje dhe Blerësi pranon që të marrë në dorëzim Punimet sipas kushteve dhe afateve të parashtruara në këtë Marrëveshje dhe të paguajë Çmimin e Shitjes.

3.2 Për shmangien e çdo dyshimi, Blerësi bie dakord që Shitësi do të ketë Punime të realizuara nga Kontraktuesi, i cili do të përzgjidhet në përputhje me dispozitat përkatëse të dhëna në Marrëveshjen e Agjencisë.

3.3 Agjencia Zbatuese përgjegjëse për zbatimin e Punimeve është Autoriteti Rrugor Shqiptar i Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës të Blerësit.

3.4 Njësia për Menaxhimin e Projektit do të krijohet në varësinë e Drejtorisë së Projekteve të Huaja të Agjencisë Zbatuese dhe do të ndjekë zbatimin e Projektit.

Seksioni - 4 Koha për realizimin e asetit

Në varësi të Seksioneve 6 dhe 10 këtu, realizimi i Asetit do të kryhet brenda 36 (Tridhjetë e Gjashtë) muajsh nga data e Disbursimit të Parë.

Seksioni - 5 Përfundimi i marrëveshjes

5.1 Blerësi mund t'i kërkojë Shitësit që të përfundojë këtë Marrëveshje dhe të anulojë Shumën e Miratuar ose çfarëdo pjese të saj në çfarëdo lloj kohe përpara nënshkrimit të Marrëveshjes së Konsulencës ose Kontratës.

5.2 Me përjashtim të rasteve kur Disbursimi është bërë nga Shuma e Miratuar përpara përfundimit, nëse Shuma e Miratuar anulohet në vijim të Seksionit XII këtu, Marrëveshja do të konsiderohet se përfundon automatikisht.

5.3 Përpara nënshkrimit të Marrëveshjes së Konsulencës ose Kontratës, Shitësi, pas konsultimit të duhur me Blerësin, pas njoftimit ndaj Blerësit, mund të përfundojë këtë Marrëveshje në secilin prej rasteve që vijojnë:

a) Pamundësia e Blerësit për të përmbushur detyrimet e tij për të paguar çfarëdo shume që i



detyrohet Shitësit ose çdo organi tjetër të Shitësit sipas çfarëdo marrëveshjeje të ndryshme nga kjo Marrëveshje;

b) Një situatë e jashtëzakonshme do të jetë krijuar, e cila;

i) sipas opinionit të Shitësit, do ta bëjë të pamundur që Blerësi të mund të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

ii) parandalon arritjen e qëllimeve për të cilat lidhet kjo Marrëveshje;

c) Një përfaqësim nga ana e Blerësit ose çdo deklaratë e dhënë ose që synohet ku do të mbështetet Shitësi në përpunimin e Projektit për miratim ose për të lidhur këtë Marrëveshje, do të ketë qenë jo i plotë ose jo korrekt në çdo aspekt material;

Marrëveshja do të vazhdojë të jetë e përfunduar derisa ngjarja ose ngjarjet që çuan në atë përfundim do të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa Shitësi të ketë njoftuar Blerësin se marrja përsipër nga ana e Shitësit për të realizuar punimet e ndërtimit të jetë rivendosur, cilado prej tyre të jetë më e hershme; me kusht që, megjithatë, në rastin e një njoftimi apo rivendosjeje të tillë, marrja përsipër për të realizuar punimet e ndërtimit do të rivendoset vetëm në masën dhe subjekt i kushteve të specifikuar në atë njoftim dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të ndikojë ose do të cenojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose kompensim të Shitësit në lidhje me çdo ngjarje tjetër ose vijuese të përshkruar në këtë Seksion.

5.4 As Shitësi, as Blerësi nuk do të kenë asnjë detyrim të mëtejshëm ndaj tjetrit nga data e anulimit të Marrëveshjes sipas Seksioneve 5.1, 5.2 ose 5.3, me kusht që ky përfundim nuk do të prejë asnjë detyrim të pësuar ose rezultuar ndaj cilësdo pale përpara atij përfundimi.

5.5 Pavarësisht nga përfundimi i Marrëveshjes, Blerësi do të vazhdojë të bashkëpunojë dhe asistojë Shitësin në rikthimin nga ana e Kontraktuesit të asaj pjese të Çmimit të Kontratës dhe çdo shume tjetër që mund të jetë disbursuar nga Shitësi përpara përfundimit të Kontratës.

Seksioni - 6 Pranimi i punimeve nga blerësi

Blerësi do të konsiderohet se ka pranuar Asetin në mënyrë të parevokueshme për të gjitha qëllimet kur Blerësi nënshkruan Çertifikatën Përfundimtare të Pranimit.

Seksioni - 7 Pronësia dhe risku

Titulli dhe risku në Punime do t'i kalojnë

Blerësit me nënshkrimin e Çertifikatës Përfundimtare të Pranimit.

Seksioni - 8 Kushtet e punimeve

8.1 Pa cenuar sa më sipër, Shitësi nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ose detyrim cilido qoftë ndaj Blerësit ose çdo personi ose organi tjetër, në lidhje me:

a) çfarëdo detyrimi, humbje ose dëmi të shkaktuar (ose të presupozuar që do të shkaktohet) në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë nga Punimet ose nga çdo pamjaftueshmëri ose mangësi ose defekt ose nga çdo rrethanë tjetër në lidhje me të;

b) shfrytëzimin ose funksionimin e Punimeve ose të gjitha rreziqet që lidhen me to;

c) çdo ndërprerje shërbimi, humbje biznesi ose fitimi të parashikuar ose dëme vijuese.

8.2 Shitësi merr përsipër që t'i japë Blerësit përfitimin e çdo garancie, kushti ose të drejte që lidhet me Punimet, të cilat mund t'i jenë dhënë nga Kontraktuesi për Shitësin dhe të cilat janë analizuar dhe pranuar nga Blerësi dhe të gjitha kushtet ose të drejtat e tjera, siç mund të nënkuptohen nga ligji ose njihen zakonisht në favor të Shitësit. Gjithashtu, Shitësi do të ndërmarrë veprime të tjera ashtu siç mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme Blerësi për t'i mundësuar Blerësit të ngrejë pretendime ndaj Kontraktuesit.

Seksioni - 9 Pagesa e çmimit të shitjes

9.1 Çmimi i Shitjes është USD 48,373,698.22 (Dollare Amerikanë - Dyzet e Tetë Milionë e Treqind e Shtatëdhjetë e Tre Mijë e Gjashtëqind e Nëntëdhjetë e Tetë e Njëzet e Dy Centë). Çmimi i Shitjes do të rillogaritet në fund të Periudhës së Realizimit mbi bazën e Kostos Kapitale plus një shtesë prej |6-muaj USD Libor| Swap Rate që dominon në kohën e rillogaritjes plus |120| pikë bazë në vit. Kostoja Kapitale do të përcaktohet mbi bazën e disbursimeve në total në fund të Periudhës së Realizimit ose kohës së shitjes plus një vlerë shtesë prej |6-muajsh USD Libor| plus |120| pikë bazë në vit që aplikohet për çdo Disbursim. Në rast se cilado vlerë reference është negative (p.sh. më pak se zero), kjo vlerë reference do të konsiderohet se është zero.

9.2 Blerësi do të paguajë Çmimin e Shitjes në 34 (Tridhjetë e Katër) këste të njëpasnjëshme gjysmë-vjetore, të cilat do të paguhet në monedhë të konvertueshme e të pranueshme për IDB, kësti i pare do të paguhet gjashtë muaj pas përfundimit të



Periudhës së Realizimit. Shitësi do t'i dërgojë Blerësit Skedën e Pagesës së Çmimit të Shitjes menjëherë pas lëshimit të Çertifikatës Përfundimtare të Pranimit.

9.3 Në varësi të Seksionit 9.6 këtu, çdo pagesë që do të bëhet nga Blerësi për Shitësin, do të realizohet në çfarëdo monedhe të konvertueshme që është e pranueshme për Shitësin për vlerën në datën e pagesës në llogarinë e Shitësit ose në çfarëdo mënyre tjetër që Shitësi mund ta njoftojë herë pas here Blerësin me shkrim.

9.4 Secila pagesë që do të kryhet këtu do të konsiderohet se është paguar siç duhet kur cilado nga bankat i konfirmon Shitësit marrjen e asaj pagese në llogarinë e Shitësit në:

Në Dollarë	Në Paund:	Në EURO:
Amerikanë:		
Llogaria nr:	Llogaria nr:	Llogaria nr:
GB36SINT609280	GB13SINT609280	FR7643899000019696
00159111	00159137	500151088
Gulf	Gulf	Union De
International	International	Banques Arabes
Bank (UK)	Bank (UK)	Et
Ltd, One	Ltd, One	Frangaises
Knightsbridge	Knightsbridge	(UBAF)
London SW1X	London SW1X	92523 Paris,
7XS	7XS	Neuilly Cedex
United	United	France
Kingdom	Kingdom	
Teleks nr.	Teleks nr.	Teleks nr. 610334
8812261/2	8812261/2	UBAF
Kodi Swift:	Kodi Swift:	Kodi Swift:
SENTGB2L	SINTGB2L	UBAFRPPXXX

9.5 Nëse ndodh që një pagesë të duhet të bëhet në një ditë e cila nuk është Ditë Pune, pagesa do të bëhet në ditën vijuese të Ditës së Punës.

9.6 Të gjitha pagesat e kryera nga Blerësi këtu do të bëhen të lira dhe pa zbritje ose në lidhje me çfarëdo takse, hipoteke, kundër-kërkese ose çështje tjetër. Nëse Blerësi, sipas ligjit, duhet të bëjë ndonjë zbritje ose të bëjë ndalesa për çfarëdo shume të pagueshme nga ai këtu, shuma e pagueshme nga ai në lidhje me këtë zbritje apo ndalesë që duhet të bëhet do të rritet deri në atë masë që është e nevojshme për të siguruar se, pas zbritjes ose ndalesës, Shitësi merr dhe mban (pa asnjë detyrim në lidhje me zbritjen apo ndalesën) një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë dhe mbajtur nëse ajo zbritje apo ndalesë nuk do të ishte kryer.

9.7 Nëse blerësi nuk paguan çfarëdo shume që duhet të paguhet sipas afatit në përputhje me

kushtet e kësaj Marrëveshjeje, atëherë përveç pagesës së asaj shume, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një tarifë për pagesën e vonuar në lidhje me pagesën e vonuar dhe çdo tarifë për pagesë të vonuar do të llogaritet dhe zbatohet si vijon:

a) një shumë e përcaktuar nga Shitësi pas aplikimit të formulës që jepet më poshtë:

Ax 1%xB “A” do të thotë shumë e papaguar;

360 “B” do të thotë numri i ditëve nga dhe duke përfshirë datën e duhur të pagesës dhe datën e pagesës faktike (para ose pas gjykimit).

b) Të gjitha kostot e shpenzimet e arsyeshme dhe të justifikuara (duke përfshirë pa kufizim, të gjitha kostot e shpenzimet ligjore ose ato të agentit mbledhës) të pësura nga Shitësi si rezultat i vonesës në pagesë.

9.8 Blerësi, pasi Shitësi ka zbritur të gjitha kostot dhe shpenzimet e pësura, do të paguajë të gjitha shumat e marra në vijim të këtij Seksioni 9.7 në Llogarinë IDB Waqf Nr. : 0000 100 102 në British Arab Commercial Bank, London, United Kingdom (Mbretëria e Bashkuar) (Kodi Swift: BACMGB2LXXX, IBAN: GB 69 BACM 4051 3200 100 102), ose në një llogari tjetër siç mund të njoftohet Blerësi;

Seksioni - 10 Përfaqësimet

Blerësi përfaqëson se:

a) ai ka kompetenca për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të përmbushur detyrimet e tij këtu dhe të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushja e detyrimeve nga Blerësi është marrë përsipër në mënyrën e duhur;

b) detyrimet e shprehura për t'u ndërmarrë nga Blerësi në këtë Marrëveshje janë të ligjshme dhe detyrime të vlefshme të detyrueshme për Blerësin në përputhje me kushtet këtu;

c) zbatimi i kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushja nga ana e Blerësit e detyrimeve të tij nuk përbëjnë dhe nuk do të rezultojnë në asnjë shkelje të asnjë marrëveshjeje, traktati apo ligji;

d) të gjitha aktet, kushtet dhe të tjera (duke përfshirë miratimin për kontrollin e shkëmbimit) të nevojshme që duhet të kryhen sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, janë përmbushur dhe realizuar me qëllim që:

i) t'i mundësojnë Blerësit që të lidhë dhe të realizojë detyrimet e shprehura për t'u ndërmarrë nga ai në këtë Marrëveshje;



ii) të sigurojë se detyrimet e shprehura për t'u ndërmarrë në këtë Marrëveshje janë të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme; dhe

iii) ta bëjë këtë Marrëveshje të pranueshme sipas të dhënave provuese në Republikën e Shqipërisë pa kryer, përmbushur apo realizuar hapa ose formalitete të mëtejshme rreptësisht në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;

e) të mos ketë filluar ose të mos jetë paralajmëruar asnjë veprim ose procedurë administrative ose përpara një gjykate ose agjencie që mund të ketë një efekt material të pafavorshëm në gjendjen financiare të Blerësit;

f) sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Shqipërisë në datën aktuale, pretendimet e Shitësit kundër Blerësit sipas kësaj Marrëveshjeje do të klasifikohen të paktën *pari passu* me pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë të pasiguruar për çfarëdo borxhi të Blerësit.

Seksioni - 11 Rastet e mosrealizimeve

11.1 Nëse një nga rastet e specifikuara në këtë Seksion (Rastet e Mosrealizimeve) do të ketë ndodhur dhe vazhdon, atëherë Shitësi, pas njoftimit të Blerësit, mund të deklarojë të gjithë ose pjesë të Çmimit të Shitjes dhe kjo do të bëhet më tej, menjëherë një shumë për t'u paguar (pavarësisht nga çdo gjë tjetër në këtë Marrëveshje) pa asnjë njoftim të mëtejshëm:

a) Mosrealizimi ka ndodhur në pagesën e çfarëdo kësti të Çmimit të Shitjes dhe ai mosrealizim ka vazhduar për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

b) Mosrealizimi [përveç mosrealizimit të specifikuar në (a) më sipër] do të ketë ndodhur në përmbushjen e çfarëdo detyrimi të Blerësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe çdo mosrealizim i tillë do të ketë vazhduar për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh.

c) Çdo përfaqësim ose garanci e konfirmuar ose e kryer nga Blerësi në lidhje me zbatimin dhe dërgimin e kësaj Marrëveshjeje, ose në lidhje me çfarëdo kërkesë për disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohet se ka qenë jo korrekt në çdo aspekt të rëndësishëm dhe do të vazhdojë të jetë jo korrekt për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh pasi t'i jetë dhënë njoftimi Blerësit nga ana e Shitësit;

d) Blerësi të ketë thirrur një mbledhje ose të ketë ndërmarrë ndonjë veprim për qëllimin e aranzhimit ose marrëveshjes me kreditorët e tij;

e) Blerësi nuk ka pasur mundësi që të paguajë borxhet e tij kur duhen ose në çfarëdo mënyre tjetër nuk ka aftësi paguese; ose çdo person në ngarkim do të ketë marrë ligjërisht pronësinë ose një marrës ose një administrues i besuar do të jetë emëruar për të gjithë ose çfarëdo pjesë të ndërmarrjes ose aseteve të Blerësit; ose një rrezik apo zbatim (ose proces analog) do të jetë ngritur ose zbatuar ose lëshuar kundër secilës pasuri të patundshme ose prone të Blerësit dhe çdo rrezik apo zbatim nuk do të jetë eliminuar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh;

f) çdo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme;

11.2 Nëse çdo Rast Mosrealizimi ose çdo rast i cili, me kalimin e kohës ose me njoftim dhe me kalimin e kohës, shndërohet në Rast Mosrealizimi, Blerësi do t'i japë menjëherë Shitësit njoftim me teleks ose faksimile, duke specifikuar natyrën e këtij Rasti Mosrealizimi ose një rast i tillë dhe të gjitha hapat që Blerësi merr për të riparuar këtë.

11.3 Asnjë marrëveshje dhe asnjë vonesë në ushtrim, ose heqje në ushtrim, në çdo të drejtë, kompetence ose rikuperim që rrjedh për Shitësin për çdo mosrealizim sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo marrëveshje tjetër nuk do të dëmtojë një të drejtë të tillë, kompetence apo rikuperim ose nuk do të interpretohet se është një heqje dorë ose një pranim i heshtur; as veprimi i Shitësit në lidhje me çdo mosrealizim të tillë, ose pranim i heshtur nga ai, nuk do të ndikojë ose cenojë në asnjë të drejtë, kompetence ose rikuperim të Shitësit në lidhje me çdo mosrealizim tjetër.

Seksioni - 12 Anulimi i shumës së miratuar

12.1 Nëse Kontrata nuk është nënshkruar brenda 180 (Njëqind e Tetëdhjetë) ditësh nga Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shitësi, pasi njofton Blerësin, mund të anulojë Shumën e Miratuar, me përjashtim të rasteve kur përmbushet nga justifikimi i Blerësit për një vonesë të tillë.

12.2 Në rast se Kontraktuesi nuk përmbush asnjë nga detyrimet e tij sipas Kontratës dhe Blerësi, në konsultim me Shitësin, përfundon Kontratën në përputhje me kushtet e saj, ky përfundim, pas 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga përfundimi, do të operojë si një anulim i çfarëdo



shume që mbetet e padisbursuar nga Shuma e Miratuar, përveçse kur Shitësi do të pranojë ndryshe.

Seksioni - 13 Hyrja në fuqi e marrëveshjes

Kjo Marrëveshja nuk do të bëhet efektive përveçse dhe derisa Blerësi i jep Shitësit një Opinion Ligjor nga Ministria e Drejtësisë së Blerësit kryesisht në formularin e dhënë në Aneksin III këtu;

Seksioni - 14 Përfundimi i Marrëveshjes për shkak të moshyrjes në fuqi

Nëse Marrëveshja nuk do të ketë hyrë në fuqi brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e nënshkrimit, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve do të përfundojnë përveçse kur Shitësi, pas marrjes në konsideratë të arsyeve për vonesë, do të përcaktojë një datë të mëvonshme për qëllime të këtij Seksioni. Shitësi do të njoftojë menjëherë Blerësin për datën e mëvonshme ose përfundimin e Marrëveshjes, sipas rastit.

Seksioni - 15 Heqja dorë

Mosushtrimi nga ana e Shitësit ose mungesa e mbrojtjes së të drejtave të tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose vonesa për këto ose mosushtrimi ose mbrojtja e çdo kompensimi që mund të ketë kundër Blerësit ose vonesa e tij në to, nuk do të cenohet të drejtën ose kompensimin dhe nuk do të interpretohet si një heqje dorë nga ajo e drejtë apo kompensim.

Seksioni - 16 Ligji i zbatueshëm -zgjidhja e mosmarrëveshjeve

16.1 Kjo Marrëveshje do të zbatohet dhe do të interpretohet në përputhje me parimet e Sherihatit islamik (siç parashtrahet në Standardet e Sherihatit të publikuara nga Organizata e Kontabilitetit dhe e Auditimit të Institucioneve Financiare Islamike dhe siç interpretohet nga Akademia Islamic Fiqh e Organizatës së Konferencës Islamike ose Komiteti i Sherihatit i IDB-së).

16.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshje dhe çdo pretendim nga cilado Palë kundër Palës tjetër që ngrihet sipas kësaj Marrëveshjeje do të paraqitet tek një panel arbitrazhi për vendimin final dhe detyrues në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës Ndërkombëtare Islamike për Pajtim dhe Arbitrazh (IICRA), Dubai, UAE. Rregullat dhe procedurat e arbitrazhit të IICRA do të jenë në vend të çdo procedure tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve të kësaj

Marrëveshjeje ose çdo pretendim që ngrihet nga cilado Palë kundër Palës tjetër. Gjuha angleze do të përdoret në të gjitha procedurat e arbitrazhit.

Seksioni - 17 Njoftime

17.1 Çdo njoftim ose kërkesë që do të jepet ose do të kryhet nga një palë për palën tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje ose në lidhje me të do të jetë me shkrim dhe mund të jepet me teleks ose letër. Ky njoftim ose kërkesë do të konsiderohet se është dhënë ose kryer siç duhet kur të dërgohet dorazi ose me postë tek pala tjetër në adresën e saj të specifikuar në Seksionin 17.2 këtu ose në çdo adresë tjetër, siç mund të jetë përcaktuar me njoftim për palën tjetër.

17.2 Për qëllime të Seksionit 17.1 këtu, palët kanë dhënë adresat e tyre si vijon:

Për Blerësin:

Ministria e Financave,
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3,
Tiranë, Shqipëri
Tel: +35542228405
Faks: +35542228494

Për Shitësin:

P.O. Box: 5925
Jeddah - 2T432
Kingdom of Saudi Arabia
Tel: +966 2 646 6019
Faks: +966 2 636 6871

[FUNDI I SEKSIONEVE]

FAQJA E NËNSHKRIMIT

NË DËSHMI TË KËSAJ, palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën e përmendur në Hyrjen e kësaj Marrëveshjeje.

PËR DHE NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR DHE NË EMËR TË BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

Aneksi - I Përshkrimi i asetit

Është propozuar që IDB të marrë pjesë në financimin e projektit nëpërmjet Istisna'a për një shumë prej US\$35,174,256.80- (Dollarë Amerikanë – Tridhjetë e Pesë Milionë e Njëqind e Shtatëdhjetë



e Katër Mijë e Dyqind e Pesëdhjetë e Gjashtë e Tetëdhjetë Centë). Financimi i IDB-së do të mbulojë sa vijon:

i) Prerja e Mulletit: Pika e Fillimit Progresivi 4+000 km – Pika e Përfundimit Progresivi 5+000 km, Gjatësia 1,000 m

ii) Rrëshqitja e Dheut Ibe: Pika e Fillimit Progresivi 10 + 800 Km - Pika e Përfundimit Progresivi 11+500 km, Gjatësia 700 m

iii) Rrëshqitja e Dheut Progresivi 12+000: Pika e Fillimit Progresivi 11+800 km - Pika e Përfundimit Progresivi 12+400 km, Gjatësia 600 m

iv) Rrëshqitja e Dheut Progresivi 13+000: Pika e Fillimit Progresivi 13+000 - Pika e Përfundimit Progresivi 13+800, Gjatësia 800 m

v) Rrëshqitja e Dheut Progresivi 14+000: Pika e Fillimit Progresivi 14+000 - Pika e Përfundimit Progresivi 14+600, Gjatësia 600 m

Aneksi - II Përshkrimi i projektit

Objektivat kryesore të projektit janë sigurimi i fluksit të pandërprerë të trafikut, reduktimi i kostove operuese të automjeteve, aksidentet e trafikut, kursimi i kohës dhe rritja ekonomike e përgjithshme në zonën e projektit. Projekti gjithashtu do të lejojë akses më të shpejtë në zonat bregdetare dhe në terrenin spektakolar malor dhe në zonën rurale përtej Elbasanit, si dhe do të sigurojë një lidhje të rëndësishme me vendet fqinje Maqedoni dhe Greqi, duke rritur aktivitetet e tregtisë, turizmit e tranzitit në Shqipëri.

Gjatësia e përgjithshme e rrugës është 27 km, nga të cilat do të ndërtohen dy tunele ku secili do të ketë nga dy korsi (gjatësitë mesatare të dy tuneleve janë 2.2 km dhe 2.3 km). Projekti përfshin elementët e mëposhtëm:

1. Punime ndërtimi

Rruga e propozuar përfshin punimet e shtresave të rrugës, tombinot dhe mbrojtjen e shtresave të rrugës, punimet e betonit, mbrojtjen e skarpateve, punimet e urave, sinjalistikën rrugore horizontale dhe vertikale.

2. Shërbimet e Konsulencës

Këto përfshijnë shqyrtimin e projektit të detajuar, asistencë në Agjencinë e Zbatimit gjatë procesit të tenderimit për përzgjedhjen e kontraktuesit të punimeve të ndërtimit dhe mbikëqyrjen gjatë ndërtimit.

3. Njësia e Menaxhimit të Projektit

Për të ndjekur zbatimin e Projektit do të krijohet një Njësi e re për Menaxhimin e Projektit. Njësia e Menaxhimit të Projektit do të përbëhet nga: drejtori, specialisti i prokurimit, tre inxhinierë kantieri, financier/ekonomist, sekretar/përkthyes, dy shoferë, pajisje dhe mobilje zyre dhe dy automjete 4x4. Njësia e Menaxhimit të Projektit do të ketë për detyrë të: (i) përgatisë të gjithë procesin e prokurimit për përzgjedhjen e konsulentëve dhe të kontraktuesve sipas udhëzimeve dhe procedurave të IDB-së; (ii) financën e projektit dhe aspektet administrative duke përfshirë menaxhimin e kontratës dhe disbursimet; (iii) vlerësimin, monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e përgjithshëm të projektit.

4. Auditimi

Një kompani audituese me reputacion e përzgjedhur nga Blerësi me miratimin e IDB-së do të ndërmarrë auditimin financiar vjetor të projektit dhe do t'i paraqesë raportet IDB-së.

Plani i propozuar për financimin e projektit jepet në tabelën më poshtë:

Plani i Propozuar i Financimit (US\$)

Komponentët e Projektit	Financimi i IDB-së	Financimi i Abu Dabi-t	Kontributi i Qeverisë së Shqipërisë	Financimi OFID (OPEC)	Shuma e Përgjithshme
Blerje (Përvetësim) Toke	-	-	4,100,000.00	-	4,100,000.00
Punime Ndërtimi					
Seksioni 1 (Rruga: Tiranë-Tunel-13 km)	106,260,247.52	30,657,034.16	-	-	136,917,281.68
Seksioni 2 (Tunel - 2.2 km)	84,683,881.98	-	-	-	84,683,881.98
Seksioni 3 (Rruga: Tunel-Elbasan-11.8 km)	56,250,047.91	16,025,621.59	-	20,056,911.37	92,332,580.87
Nëntotal-1	247,194,177.41	46,682,655.75	-	20,056,911.37	313,933,744.53



Shërbime Konsulence					
Studimi i Fizibilitetit & Projekti i detajuar	-	-	2,900,000.00	-	2,900,000.00
Seksioni 1 (Mbikëqyrje)	3,191,541.81	2,096,871.19	-	-	5,288,413.00
Seksioni 2 (Mbikëqyrje)	2,156,740.20	-	-	-	2,156,740.20
Seksioni 3 (Mbikëqyrje)	1,280,628.58	1,220,473.06	-	-	2,501,101.64
Nëntotal -2	6,628,910.59	3,317,344.25	2,900,000.00	-	12,846,254.84
Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU)	931,900.00	-	-	-	931,900.00
Auditim Financiar	58,695.00	-	-	-	58,695.00
Nëntotal -3	990,595.00	-	-	-	990,595.00
TOTAL	254,813,683.00	50,000,000.00	7,000,000.00	20,056,911.37	331,870,594.37
Fondi Rezervë (10%)	3,060,573.80	-	-	343,088.63	3,403,662.43
SHUMA E PËRGJITHSHME	257,874,256.80	50,000,000.00	7,000,000.00	20,400,000.00	335,274,256.80
Përqindja (%)	76.91	14.91	2.09	6.08	100.00

¹ Diferenca ndërmjet këtij totali dhe shumës së miratuar nga Banka më datën 26/02/2011G përfaqëson shumën e financimit shtesë.

Aneksi - III Formulari i opinionit të Ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë

(BLERËSI)

[TË PRINTOHET NË LETËR ME LOGO]

Banka Islamike e Zhvillimit P.O. Box: 5925
Jeddah-21432 Kingdom of Saudi Arabia
(Mbretëria e Arabisë Saudite)

Të nderuar Zotërinj,

Në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë ("Blerësi"), kam shqyrtuar origjinalet (ose kopjet) e çertifikuara ose të identifikuar ndryshe në mënyrë të pranueshme nga unë të Marrëveshjes Istisna'a dhe të Marrëveshjes së Agjencisë me datë ____/____/2011G ("Marrëveshjet") të hartuara për financimin e projektit të Punimeve të Ndërtimit për Projektin e Rrugës Tiranë-Elbasan, Shqipëri ("Aseti") nga Banka Islamike e Zhvillimit ("Shitësi") për Blerësin dhe caktimin e Blerësit si Agjent të Shitësit dhe me marrëveshjen e Shitësit për mbikëqyrjen e Punimeve dhe shitjen e tyre tek Blerësi dhe dokumentet e tjera të tilla siç e kam çmuar të nevojshme ose të përshtatshme si bazë për opinionet e shprehura këtu.

Opinionet e shprehura këtu kufizohen në pyetjet e ngritura sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe nënndarjet e saj politike dhe unë nuk pretendoj të shpreh ndonjë opinion apo pyetje që lind sipas ligjeve të ndonjë juridiksioni tjetër.

Të gjitha kushtet e përcaktuara në Marrëveshje dhe të përdorura, por jo të përkufizuara këtu kanë kuptimet që u janë dhënë në Marrëveshje.

Në bazë të informacioneve që jepen më sipër, opinionimi im është që:

a) Blerësi ka kompetencë dhe autoritet që të zotërojë pronën e tij, të drejtë biznesin e tij siç e drejton aktualisht dhe të realizojë transaksionet e parashikuara në Marrëveshje.

b) Blerësi ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për të autorizuar zbatimin dhe dërgimin e Marrëveshjeve dhe të gjitha dokumentet e tjera për t'u zbatuar dhe dërguar në lidhje me Marrëveshjen, përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Marrëveshjeve dhe realizimin e transaksioneve të parashikuara në Marrëveshje.

c) Marrëveshjet janë zbatuar dhe dërguar në mënyrën e duhur nga Blerësi dhe përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Blerësit që zbatohen kundër Blerësit në përputhje me termat, në varësi të paaftësisë paguese, moratoriumit dhe ligjeve të ngjashme që cenojnë të drejtat e kreditorëve në përgjithësi.

d) Të gjitha autorizimet qeveritare dhe veprimet e çfarëdo lloji të nevojshme për të autorizuar ose për vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e detyrimeve të parashikuara në Marrëveshje kundër Blerësit janë marrë ose përmbushur dhe janë të vlefshme dhe në fuqi dhe efekt të plotë.

e) Asnjë rast nuk ka ndodhur dhe nuk vazhdon që të përbëjë, ose që, me dhënien e njoftimit ose kalimin e kohës ose të dyja, do të përbënte, një mosrealizim sipas çfarëdo marrëveshjeje ose



instrumenti që evidenton çfarëdo detyrimi të Blerësit dhe asnjë rast i tillë nuk do të ndodhë me kryerjen e çfarëdo disbursimi sipas Marrëveshjeve.

f) Asnjë miratim ose aprovim, ose njoftim i çdo kreditori të Blerësit nuk është i detyrueshëm sipas termave të çfarëdo marrëveshjeje ose instrumenti që evidenton çfarëdo detyrimi të Blerësit për zbatimin ose dërgesën, ose përmbushjen e detyrimeve të Blerësit sipas Marrëveshjeve ose kryerjen e transaksioneve të parashikuara në Marrëveshje, dhe ai zbatim, dërgesë, realizim dhe përmbushje nuk do të rezultojë në asnjë shkelje ose nuk do të përbëjë asnjë mosrealizim sipas kartës ose urdhëresave të Blerësit ose çdo marrëveshje, instrument, gjykim, ose urdhër i njohur për mua, ose çdo statut, rregull ose rregullore që aplikohet për Blerësin ose për çfarëdo prone të tij.

g) Nuk ka asnjë veprim ose procedura pezull, sipas njohurive të mia, që të kërcënojnë raste të pafavorshme, përcaktimi i të cilave mund të ketë një efekt të pafavorshëm në aspektin material në gjendjen financiare të Blerësit ose të cenojë aftësinë e Blerësit për të përmbushur detyrimet e tij ose të cenojë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e Marrëveshjeve.

h) Blerësi ka titull të mirë për pronën e tij të lirë dhe pa asnjë barrë dhe pengesa të tjera, dhe detyrimet e tij sipas Marrëveshjes klasifikohen të paktën *pari passu* me të gjitha detyrimet e tij të tjera të pasiguruar.

i) Zbatimi dhe dërgimi i Marrëveshjeve nuk janë objekt i asnjë takse, detyrimi, tarife apo tatimi tjetër, duke përfshirë, pa kufizim, çdo taksë regjistrimi ose transferimi, detyrim për pullë ose taksë të ngjashme, të vendosur nga ose brenda Republikës së Shqipërisë ose çdo nënndarje politike ose autoritet taksues.

j) Blerësi, deri në masën maksimale të lejuar nga ligjet e Republikës së Shqipërisë, heq dorë nga imuniteti i tij mbi bazën e sovranitetit në lidhje me çdo veprim ose procedurë që lidhet në çfarëdo mënyrë me Marrëveshjet që mund të paraqiten në gjykatat e Republikës së Shqipërisë.

k) Në çdo rast kur Huamarrësi nuk heq dorë nga çfarëdo imuniteti, për sa i takon zbatimin, në lidhje me:

“Vendndodhja aktuale ose e ardhshme e misionit”, siç përkufizohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, nënshkruar në vitin 1961, “vendndodhja aktuale ose e ardhshme

konsullore”, siç përkufizohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, nënshkruar në vitin 1963 ose që shfrytëzohet ndryshe nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë ose çdo agjenci ose instrument;

çdo pronë e patundshme sipas dispozitave të Nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001 “Mbi pronat e paluajtshme shtetërore”;

çdo fond monetar dhe/ose shumë që është paguar tashmë në kohën e zbatimit për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas traktateve ndërkombëtare ligjore, konventave dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara nga ajo.

l) Zbatimi dhe dërgimi i Marrëveshjeve nga Blerësi dhe përmbushja e detyrimeve të tij përbëjnë transaksione komerciale.

m) Zgjedhja nga palët e Marrëveshjeve të Parimeve të Sherihatit Islamik si ligj zbatues është e ligjshme, e vlefshme dhe detyruese.

n) Nuk është e nevojshme të sigurosh se ligjshmëria, vlefshmëria, zbatueshmëria ose pranueshmëria e provave në gjykatat e Republikës së Shqipërisë së Marrëveshjeve depozitohet, regjistrohët, ose shënohet në çfarëdo gjykate ose agjencie qeveritare ose në Republikën e Shqipërisë ose stampuar me çfarëdo stampe ose takse transaksioni të ngjashëm.

o) Nuk është e nevojshme sipas ligjeve të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë që, për t'i mundësuar Shitësit zbatimin e të drejtave të tij sipas Marrëveshjeve ose për zbatimin e Marrëveshjeve ose përmbushjen nga Shitësi të detyrimeve të tij, që Shitësi të jetë i licencuar, i kualifikuar ose që të ketë të drejtë të vazhdojë biznesin në Republikën e Shqipërisë.

p) Shitësi nuk do të konsiderohet se është banor, me vendbanim për të drejtuar biznesin apo subjekt i tatimit në Republikën e Shqipërisë vetëm për arsye të përmbushjes, realizimit dhe/ose zbatimit të Marrëveshjeve, realizimit të punimeve të ndërtimit nga Shitësi dhe shitjes tek Blerësi në vijim të Marrëveshjeve dhe nuk do të vendoset asnjë taksë në asnjë shumë që merret nga Shitësi sipas Marrëveshjeve.

Me përjashtim të rasteve dhe derisa unë t'i jap njoftim Shitësit për çfarëdo ndryshimi në këtë opinion përpara disbursimit të fondeve sipas Marrëveshjes, ju dhe avokati juaj mund të mbështeten në këtë opinion gjatë gjithë kohës duke



filluar nga data këtu dhe duke përfshirë këtë disbursim sikur opiniononi të ishte i kësaj date dhe i kësaj dite, i dërguar po në këtë kohë.

Me respekt,

Emri:

Titulli:

Projekti Nr:2 ALB0033.1

**MARRËVESHJA
E AGJENCISË ISTISNA'A (FINANCIM
SHITESË) NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE
PËR ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E
RRUGËS TIRANË-ELBASAN**

Marrëveshja e Agjencisë

Kjo Marrëveshje lidhet në datën ____/____/1437H (që i korrespondon ____/____/2016G) ndërmjet KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (referuar më poshtë si “Agjent”) dhe BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (referuar më poshtë si “IDB”).

Agjenti dhe IDB të referuar më poshtë individualisht si “Palë” dhe bashkërisht si “Palët”.

Duke pasur parasysh që;

A. IDB ka pranuar në përputhje me marrëveshjen në këtë datë (e referuar më poshtë si “Marrëveshja Istisna’a (Financim Shtesë)” të realizojë Punimet e ndërtimit për Projektin e rrugës Tiranë - Elbasan, Shqipëri përshkruar në Aneksin I këtu (të referuara më poshtë si “Aseti”) për shfrytëzim në Projektin e përshkruar në Aneksin-II këtu;

B. IDB ka rënë dakord me Agjentin që Agjenti, në emër të IDB-së të lidhë Kontratë me Kontraktuesin dhe të mbikëqyrë realizimin e Asetit;

C. Agjencia Zbatuese përgjegjëse për zbatimin e Projektit në emër të Blerësit do të jetë Autoritetit Rrugor Shqiptar i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës të Blerësit.

Si rrjedhojë, IDB dhe Agjenti bien dakord këtu për sa vijon:

Seksioni - 1 Përkufizime – interpretimi

1.1 Në këtë Marrëveshje, përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe, termat që vijojnë do të kenë

kuptimin që jepet përkundrejt secilës prej tyre këtu më poshtë:

Shuma e Miratuar: Shuma prej US\$35,174,256.80- (Dollarë Amerikanë – Tridhjetë e Pesë Milionë e Njëqind e Shtatëdhjetë e Katër Mijë e Dyqind e Pesëdhjetë e Gjashtë e Tetëdhjetë Centë) miratuar nga IDB për realizimin e Asetit.

Kostoja Kapitale: Kostoja totale e realizimit të Asetit, e cila do të përfshijë Çmimin e Kontratës, tarifat e Konsulentit dhe të gjitha kostot ose shpenzimet e tjera të kryera nga IDB në ose në lidhje me realizimin e Asetit dhe mbikëqyrjen e ndërtimeve.

Marrëveshja e Konsulencës: Marrëveshja me Konsulentin për ofrimin e shërbimeve të konsulencës që i përkasin Asetit që do të realizohet nga Blerësi në emër të Shitësit në vijim të Seksionit 5 këtu.

Konsulenti: Konsulenti të cilit do t'i besohet projektimi, mbikëqyrja (mbikëqyrja inxhinierike) dhe koordinimi i Punimeve që do të kryhen sipas Kontratës, siç jepet në Marrëveshjen e Konsulencës.

Çmimi i Kontratës: Çmimi që i paguhet Kontraktuesit për realizimin e Asetit.

Kontrata: Kontrata për realizimin e Asetit e lidhur në emër të IDB nga Agjenti me Kontraktuesin.

Kontraktuesi: Kontraktuesi, të cilit do t'i besohet realizimi i Asetit.

Data e Disbursimit të Parë: Data në të cilën IDB kryen disbursimin e parë sipas Kontratës, ose për Konsulentin, cilado të jetë më e hershme.

Data e Hyrjes në Fuqi: Data në të cilën IDB e deklaron këtë Marrëveshje në fuqi në përputhje me Seksionin -12 këtu.

Çertifikata Përfundimtare e Pranimit: Çertifikata e lëshuar nga Konsulenti në përputhje me kushtet e Kontratës, e cila përcakton se realizimi i Asetit është kryer në mënyrë të pranueshme nga Kontraktuesi. Çertifikata duhet të nënshkruhet gjithashtu edhe nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Periudha e Realizimit: Periudha që fillon nga Data e Disbursimit të Parë dhe përfundon 36 (Tridhjetë e Gjashtë) muaj më pas.

Çertifikata Paraprake e Pranimit: Çertifikata e lëshuar nga Konsulenti në përputhje me kushtet e Kontratës, e cila përcakton se realizimi i Asetit është kryer në mënyrë të pranueshme nga



Kontraktuesi. Çertifikata duhet të nënshkruhet gjithashtu edhe nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Projekti: Projekti i përshkruar në Aneksin II këtu.

Taksa: Të gjitha taksat, detyrimet, tatimet ose pagesa të tjera të natyrës së ngjashme (duke përfshirë pa kufizim çdo penalitet të pagueshëm në lidhje me çdo mospagesë ose vonesë në pagesën e tyre).

Punimet: Punimet e përshkruara në Aneksin - I këtu.

1.2 Në këtë Marrëveshje:

a) Përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe, fjalët që tregojnë numrin njëjës përfshijnë edhe numrin shumës dhe anasjelltas, fjalët që tregojnë persona përfshijnë korporata dhe partneritete; dhe referenca ndaj një Aneksi, Shtojce ose Seksioni të specifikuar është një reference ndaj atij Aneksi, Shtojce, Seksioni të kësaj Marrëveshjeje.

b) Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen Istisna'a me Ndryshime dhe të Riparaqitur dhe që nuk janë përcaktuar këtu do të kenë të njëjtin kuptim siç jepet në Marrëveshjen Istisna'a me Ndryshime dhe të Riparaqitur.

c) Titujt e Seksionit përfshihen vetëm për lehtësi reference dhe nuk do të shfrytëzohen për të përkufizuar, interpretuar ose kufizuar asnjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni - 2 Hyrja dhe anekset pjesë e marrëveshjes

Hyrja dhe Anekset e kësaj Marrëveshjeje do të jenë pjesë integrale e saj.

Seksioni - 3 Përzgjedhja e kontraktuesit dhe qëshitet e tjera të prokurimit

3.1 Pranohet ndërmjet palëve këtu se Agjenti, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar në konsultim me IDB dhe në përputhje me ligjin shqiptar për prokurimin publik, me kusht që të jetë në përputhje me Procedurat e Prokurimit të IDB dhe subjekt i miratimit të tij, do të japë të gjitha kontratat e financuara sipas kësaj Marrëveshjeje për zbatimin e Projektit si vijon:

a) Paketa e punimeve civile për punimet e tunelit do të prokurohet nëpërmjet Tenderimit Ndërkombëtar Konkurrues me udhëzimet dhe procedurat e prokurimit të IDB-së.

b) Paketa e punimeve civile për rrugën do të prokurohet përmes Tenderimit Konkurrues Ndërkombëtar (ICB) e kufizuar në firmat e ndërtimit nga shtetet anëtare të IDB-së (ICB-MC)

në përputhje me udhëzimet dhe procedurat e prokurimit të IDB-së.

c) Konsulenti për punimet në tunel do të përzgjidhet nëpërmjet ligjit shqiptar për prokurimin publik. Konsulenti për punimet rrugore do të përzgjidhet nëpërmjet një Liste Përzgjedhëse të kompanive për ndërtimin e rrugëve të Shteteve Anëtare të IDB-së në përputhje me udhëzimet e prokurimit të IDB.

d) Audituesi për Projektin do të përzgjidhet në përputhje me ligjin shqiptar të prokurimeve për sa kohë që është në përputhje me udhëzimet e prokurimit të IDB.

e) Pajisjet e Njesisë për Menaxhimin e Projektit do të përvetësohen nëpërmjet Blerjeve Kombëtare.

3.2 Agjenti, në emër të IDB do të negociojë dhe do të lidhë një Kontratë me Kontraktuesin, në bazë të sa vijon:

a) Kushtet dhe afatet e Kontratë do të pranohen ndërmjet IDB dhe Agjentit.

b) Çmimi i Kontratës nuk do të tejkalojë US\$35,174,256.80- (Dollarë Amerikanë – Tridhjetë e Pesë Milionë e Njëqind e Shtatëdhjetë e Katër Mijë e Dyqind e Pesëdhjetë e Gjashtë e Tetëdhjetë Centë) për komponentët e financuar IDB.

c) Periudha për realizimin e Asetit sipas Kontratës nuk do të tejkalojë 36 (Tridhjetë e Gjashtë) muaj nga Data e Disbursimit të Parë.

d) Specifikimet e Asetit sipas Kontratës do të jenë si ato të përshkruara shkurtimisht në Aneksin - I të kësaj Marrëveshjeje dhe të detajuara në Kontratë.

e) Pas përfundimit, Asetit do të merret në dorëzim në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Agjenti nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar.

f) Miratimi me shkrim i IDB-së për kushtet dhe afatet e Kontratës së negociuar do të merren përpara lidhjes së Kontratës nga Agjenti.

g) Kontrata do të përcaktojë se Kontraktuesi do të prokurojë një siguracion për të gjitha risqet e Kontraktuesit si të zakonshme në tregti, të ardhurat e sigurimit do t'i paguhen IDB-së në Dollarë Amerikanë dhe IDB emërtohet si i paguari i humbjes sipas politikave të sigurimit që janë kryer.

Seksioni - 4 Ndryshimet dhe amendamentet e kontratës

Agjenti, pa miratimin paraprak me shkrim të IDB-së, nuk do të bëjë asnjë ndryshim, amendament apo modifikim të Kontratës që mund (a) të rezultojë në rritje të Çmimit të Kontratës ose



(b) të rezultojë në një shtyrje të datës për përfundim ose (c) të rezultojë në një ndryshim specifikimi ose (d) jo në përputhje me praktikën e mirë të zakonshme.

Seksioni - 5 Emërimi i një konsulenti

5.1 Është rënë dakord ndërmjet IDB dhe Agjentit se do të përzgjidhet një Konsulent për Menaxhimin e Projektit (PMC) nëpërmjet një liste përzgjedhëse të firmave konsulente të Shteteve Anëtare të IDB për punimet rrugore dhe nëpërmjet një Liste Përzgjedhëse të konsulentëve ndërkombëtarë për tunelin, e cila do të pranohet ndërmjet IDB dhe Agjentit, në përputhje me udhëzimet dhe procedurat e IDB-së. Konsulenti së bashku me Autoritetin Rrugor Shqiptar do të jetë përgjegjës për të verifikuar të gjitha kërkesat për disbursim që do të paguhet nga IDB. Konsulenti i përmendur do të jetë gjithashtu përgjegjës për të koordinuar të gjitha aktivitetet, për të dhënë raporte të rregullta progresi, për të siguruar se të gjitha politikat dhe procedurat e IDB-së ndiqen rreptësisht gjatë gjithë zbatimit të Punimeve.

5.2 Termat dhe referenca e kontratës PMC për punimet rrugore do të pranohen me shkrim ndërmjet Agjentit dhe IDB përpara ftesës së propozimeve nga konsulentët e listës përzgjedhëse.

5.3 Agjenti do të shoqërojë IDB-në në bisedimet për përzgjedhjen e Konsulentëve, rezultati i së cilës do të jetë subjekt i miratimit përfundimtar të IDB-së dhe Agjentit.

5.4 Agjenti merr përsipër që në menaxhimin e Kontratës nga ana e tij, ai do të ushtrojë standardin më të lartë të kujdesit dhe vëmendjes në monitorim, (me asistencën e Konsulentit referuar Seksioneve 5.1, 5.2 dhe 5.3 këtu), realizimin e përpiktë dhe korrekt nga Kontraktuesi të detyrimeve të tij sipas Kontratës duke siguruar që Asetit do të realizohet në përputhje me specifikimet brenda kohës dhe për çmimin e përcaktuar në Kontratë.

5.5 Pa cenuar përgjithësinë e Seksionit 5.4 këtu, Autoriteti Rrugor Shqiptar në emër të Agjentit do të jetë i detyruar që:

a) të këshillojë IDB-në, sa më shpejt që të jetë e zbatueshme, për çdo vonesë ose vonesë të parashikuar në realizimin e Asetit me detaje të plota;

b) të trajtojë të gjitha çështjet rregullatore dhe administrative që lidhen me realizimin e Asetit në përputhje me ligjet përkatëse në Republikën e Shqipërisë.

c) të nënshkruajë Çertifikatën Paraprake të Pranimit dhe Çertifikatën Përfundimtare të Pranimit nëse ai është i kënaqur që Punimet në stadin përkatës janë zbatuar në përputhje me Kontratën, duke përfshirë Specifikimet.

5.6 Nëse ka shkelje të Seksionit 5 këtu, Agjenti i jep udhëzime Kontraktuesit si rezultat i të cilave ka një rritje në Çmimin e Kontratës ose IDB bëhet përgjegjëse ndaj çdo pale për çdo dëm, humbje, dëmtim, ose shpenzim, më pas Agjenti bie dakord që të mbartë rritjen në Çmimin e Kontratës ose, sipas rastit, të dëmshpërblejë IDB-në për çdo pretendim, humbje, dëmtim ose shpenzim.

5.7 Është rënë dakord që Agjenti do të sigurojë një numër personeli si të jetë e nevojshme për të realizuar detyrat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe sipas Kontratës.

5.8 Agjenti nuk do të ketë të drejtë për asnjë pagesë ose shumë tjetër pagese IDB në lidhje me ose që lind nga emërimi i Agjentit si Mbikëqyrës i IDB-së sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni - 6 Disbursimi i shumës së miratuar

6.1 IDB do të disburtojë Shumën e Miratuar në mënyrën e parashtruar në Kontratë dhe në përputhje me Procedurat e Disbursimit të IDB-së.

6.2 Data e Kërkesës së Disbursimit të Parë: Nëse brenda 180 ditësh nga data e Hyrjes në Fuqi, ose në një datë të mëvonshme, siç do të pranohet ndërmjet Agjentit dhe Bankës, Agjenti nuk ka paraqitur një kërkesë drejtuar Bankës për të kryer Disbursimin e Parë, Banka mund të përfundojë këtë Marrëveshje duke kryer njoftimin përkatës për Agjentin.

6.3 Data e Mbylljes së Disbursimit: 31/12/2019, ose një datë të mëvonshme, siç do të pranohet ndërmjet Agjentit dhe Bankës është Data e Mbylljes së tërheqjes sipas kësaj Marrëveshjeje.

6.4 Pa cenuar përgjithësinë e Seksionit 6.1 këtu, Autoriteti Rrugor Shqiptar në emër të Agjentit:

a) kur të paraqesë aplikimin për Disbursimin e parë për Konsulentin, do të sigurojë një kopje të Marrëveshjes së Konsulencës të nënshkruar.

b) kur të paraqesë aplikimin për Disbursimin e parë sipas Kontratës, do të sigurojë një kopje të nënshkruar të Kontratës (nëse nuk është paraqitur më herët) dhe kopje të policës së sigurimit referuar në Seksionin 3.2(g) të saj.

6.5 IDB nuk do të jetë e detyruar që të kryejë ndonjë Disbursim këtu nëse aplikimi i Disbursimit



nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje ose nëse dokumentet e paraqitura nga Agjenti nuk janë të plota ose me të meta. Agjenti do të jetë përgjegjës për çdo vonesë në kryerjen e Disbursimit nëse kjo vonesë ndodh për shkak që aplikimi nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje ose për shkak të pamjaftueshmërisë ose mospërputhjes në dokumentet e nevojshme.

Seksioni - 7 Marrja në dorëzim e asetit

7.1 Është rënë dakord se Kontrata do të sigurojë marrjen në dorëzim të Asetit pas përfundimit në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Agjenti. Pranohet gjithashtu se në asnjë rast IDB nuk do të jetë përgjegjëse për Agjentin për ndonjë humbje që rezulton nga ndonjë vonesë në marrjen në dorëzim të Asetit.

7.2 Për të shmangur dyshimet, është rënë dakord që, nëse Agjenti, pas nënshkrimit të Çertifikatës Përfundimtare të Pranimit, refuzon të marrë në dorëzim Asetin nga Kontraktuesi për asnjë arsye cilado qoftë, Agjenti do të dëmshpërblejë IDB-në për të gjitha kostot, shpenzimet ose humbjen që rezulton nga kjo.

Seksioni - 8 Përfaqësimet dhe garancitë

Agjenti përfaqëson dhe garanton se:

8.1 ai ka kompetenca për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të përmbushur detyrimet e tij këtu dhe të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushja e detyrimeve nga Agjenti është marrë përsipër në mënyrën e duhur;

8.2 detyrimet e shprehura për t'u ndërmarrë nga Agjenti në këtë Marrëveshje janë të ligjshme dhe detyrime të vlefshme të detyrueshme për Agjentin në përputhje me kushtet këtu;

8.3 zbatimi i kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushja nga ana e Agjentit e detyrimeve të tij nuk përbëjnë dhe nuk do të rezultojnë në asnjë shkelje të asnjë marrëveshjeje, traktati apo ligji;

8.4 të gjitha aktet, kushtet dhe sendet (duke përfshirë miratimin për kontrollin e shkëmbimit) e nevojshme që duhet të kryhen sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, janë përmbushur dhe realizuar me qëllim që;

i) t'i mundësojnë Agjentit që të lidhë dhe të realizojë detyrimet e shprehura për t'u ndërmarrë nga ai në këtë Marrëveshje,

ii) të sigurojë se detyrimet e shprehura për t'u ndërmarrë nga në këtë Marrëveshje janë të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme, dhe

iii) ta bëjë këtë Marrëveshje të pranueshme sipas të dhënave provuese në Republikën e Shqipërisë pa kryer, përmbushur apo realizuar hapa ose formalitete të mëtejshme në përputhje të rreptë me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;

8.5 të mos ketë filluar ose të mos jetë paralajmëruar asnjë veprim ose procedurë administrative ose përpara një gjykate ose agjencie që mund të ketë një efekt material të pafavorshëm në gjendjen financiare të Agjentit;

8.6 sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Shqipërisë në datën aktuale, pretendimet e Shitësit kundër Agjentit sipas kësaj Marrëveshjeje do të klasifikohen të paktën *pari passu* me pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë të pasigurt për çfarëdo borxhi të Agjentit.

Seksioni - 9 Dëmshpërblimi

9.1 Agjenti merr përsipër që të dëmshpërblejë IDB-në, mbi një bazë neto pas taksave (sipas tarifave tatimore lokale dhe të huaja që aplikohen) dhe bie dakord që të mbrojë, ruajë dhe mbajë të padëmtuar IDB-në nga të gjitha detyrimet, tarifat, humbjet, dëmet, penaltitetet, kërkesat, veprimet, gjykimet dhe shpenzimet, duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e duhura ligjore (duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet ligjore të pësura në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje), të çfarëdo toke dhe natyre që vendoset, pësohet ose shpallet kundër një IDB që lind nga:

a) pronësia, zotërimi, shfrytëzimi, dokumentacioni, heqja, kthimi ose aplikime ose dispozita të tjera sipas Kontratës ose Marrëveshjes së Konsulencës duke përfshirë çfarë mund të lindë nga:

i) çdo humbje ose dëm ndaj çfarëdo prone ose vdekje ose dëmtim të çfarëdo personi;

ii) patenta ose defekte të fshehura në Aset;

iii) çdo pretendim bazuar në përgjegjësinë e rreptë në shkelje të drejtash ose ndryshe;

iv) çdo pretendim bazuar në shkeljen e patentës, markës ose të drejtës së autorit;

v) çdo pretendim bazuar në përgjegjësinë që lind sipas ligjeve mjedisore që zbatohen ose miratimeve mjedisore;

vi) çdo pretendim në lidhje me titullin e Asetit ose tokën në të cilën është ndërtuar;

vii) çdo pretendim ose konflikt në lidhje me Kontratë ose çdo Letër Kreditimi të përcaktuar në vijim të ose në lidhje me Konsulencën.

b) ndodhia e çfarëdo mosrealizimi ose çdo mosrealizimi në anën e Agjentit ose Kontraktuesit



për të realizuar ose për të qenë në përputhje me çdo kusht të kësaj Marrëveshjeje, ose çdo dokument, marrëveshje ose kontratë të lidhur në lidhje me sa përmendet këtu ose ndryshe në lidhje me Asetin, por duke përjashtuar çdo pretendim bazuar në çfarëdo mosrealizim në anën e IDB-së për të qenë në përputhje me detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo dokument, marrëveshje ose kontratë të lidhur nga IDB në lidhje me sa përmendet këtu ose ndryshe në lidhje me Asetin;

c) çdo pretendim, barrë, interesa sigurimi, dhe pengesa si garanci pagese ose procese ligjore në lidhje me titullin ose interesin në Aset ose tokën në të cilën ndërtohet.

9.2 Agjenti do t'i japë IDB-së njoftim të menjëhershëm në lidhje me çdo ndodhi ose kusht të njohur për Agjentin si pasojë e të cilës IDB ka të drejtë ose mund t'i jepet e drejta për dëmshpërblim. Dëmshpërblimi i dhënë në Seksionin 9.1 do të aplikohet dhe do të përfshijë në mënyrë specifike pretendimet ose veprimet e shkaktuara ose në emër të punonjësve të Agjentit dhe Agjenti heq dorë shprehimisht, si kundër IDB-së, nga çdo imunitet për të cilin Agjenti mund të ketë të drejtë sipas ligjeve që zbatohen. Agjenti, me kërkesë të IDB-së (por, në çdo rast brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga ajo kërkesë) do të rimbursojë IDB-në për shumat e shpenzuara nga ajo në lidhje me të gjitha sa më lart ose do të paguajë këto shuma në mënyrë të drejtpërdrejtë. Agjenti do të përfitojë të drejtat e IDB-së në çdo çështje në lidhje me të cilën Agjenti ka rimbursuar tashmë IDB-në për shumat e shpenzuara nga ai ose ka paguar shuma drejtpërdrejt në vijim të Seksionit 9.1. Në rast se çfarëdo veprim ose procedurë shkaktohet kundër IDB-së në lidhje me çdo pretendim të dëmshpërblës, IDB, pas marrjes së njoftimit të fillimit të atij veprimi ose procedure, do të njoftojë Agjentin, duke bashkëlidhur një kopje të të gjitha dokumenteve të shërbyer në IDB. Agjenti, me kërkesë të IDB-së, do të rezistojë dhe do të mbrojë veprimet ose procedura të tilla me shpenzime të Agjentit, ose ato do të përballohen ose mbrohen nga avokati i përzgjedhur nga Agjenti në mënyrë të pranueshme për IDB-në. Në rastin e çfarëdo mosrealizimi nga Agjenti për të vepruar kështu, Agjenti do të paguajë të gjitha kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e avokatit) të pësura nga IDB në lidhje me këtë veprim apo procedurë.

Seksioni - 10 Raportet

Agjenti, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar merr përsipër që të paraqesë raportet që vijojnë tek IDB:

a) Brenda 3 (Tre) muajsh pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes dhe më pas çdo tre muaj, një raport mbi progresin dhe zbatimin e Kontratës në mënyrë të tillë që IDB mund të specifikojë kohë pas kohe;

b) 90 (Nëntëdhjetë) ditë pas përfundimit të çdo viti financiar, një raport mbi gjendjen financiare të Agjentit dhe rezultatet e operacioneve të tij gjatë vitit financiar të përfunduar së bashku me deklaratat e audituara të llogarive, duke përfshirë bilancin dhe llogarinë e fitimeve dhe humbjeve për vitin financiar të përfunduar;

c) Menjëherë pas lëshimit të Çertifikatës Përfundimtare të Pranimit, por jo më vonë se gjashtë muaj pas lëshimit të asaj Çertifikate, do të paraqesë një raport realizimi me një qëllim të tillë dhe me ato detaje që IDB mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme mbi realizimin e Asetit dhe funksionimin fillestar të Projektit;

d) Çdo raport ose informacion tjetër që mund të kërkojë herë pas here IDB.

Seksioni - 11 Heqja dorë

Mos-ushtimi nga ana e IDB-së ose mungesa e mbrojtjes së të drejtave të tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose vonesa për këto ose mos-ushtimi ose mbrojtja e çdo kompensimi që mund të ketë kundër Agjentit ose vonesa e tij në to, nuk do të cenojë të drejtën ose kompensimin dhe nuk do të interpretohet si heqje dorë nga ajo e drejtë apo kompensim.

Seksioni - 12 Data e hyrjes në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes Istisna'a (Financim Shtesë).

Seksioni - 13 Ligji që zbatohet -zgjidhja e mosmarrëveshjeve

13.1 Kjo Marrëveshje do të zbatohet dhe do të interpretohet në përputhje me parimet e Sherihatit Islamik (siç parashtrohet në Standardet e Sherihatit të publikuara nga Organizata e Kontabilitetit dhe e Auditimit të Institucioneve Financiare Islamike dhe siç interpretohet nga Akademia Islamike Fiqh e Organizatës së Konferencës Islamike ose Komiteti i Sherihatit i IDB-së).

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshje dhe çdo pretendim nga cilado



Palë kundër Palës tjetër që ngrihet sipas kësaj Marrëveshjeje do të paraqitet tek një panel arbitrazhi për vendimin final dhe detyrues në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës Ndërkombëtare Islamike për Pajtim dhe Arbitrazh (IICRA), Dubai, UAE. Rregullat dhe procedurat e arbitrazhit të IICRA do të jenë në vend të çdo procedure tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve të kësaj Marrëveshjeje ose çdo pretendim që ngrihet nga cilado Palë kundër Palës tjetër. Gjuha angleze do të përdoret në të gjitha procedurat e arbitrazhit.

Seksioni - 14 Njoftimet

14.1 Çdo njoftim ose kërkesë që do të jepet ose do të kryhet nga një palë për palën tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje ose në lidhje me të do të jetë me shkrim dhe mund të jepet me teleks ose letër. Ky njoftim ose kërkesë do të konsiderohet se është dhënë ose kryer siç duhet kur të dërgohet dorazi ose me postë tek pala tjetër në adresën e saj të specifikuar në Seksionin 14.2 këtu ose në çdo adresë tjetër, siç mund të jetë përcaktuar me njoftim për palën tjetër.

14.2 Për qëllime të Seksionit 14.1 këtu, palët kanë dhënë adresat e tyre si vijon:

Për Agjentin:

Ministria e Financave,
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr 3,
Tiranë, Shqipëri
Tel: +35542228405
Faks: +35542228494

Për IDB-në:

P.O. Box: 5925
Jeddah-21432
Kingdom of Saudi Arabia
Tel: +966 2 646 6019
Faks: +966 2 636 6871

[FUNDI I SEKSIONEVE]

FAQJA E NËNSHKRIMIT

DUKE QENË TË PRANISHME, palët këtu kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën e përmendur në Hyrjen e kësaj Marrëveshjeje.

PËR DHE NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR DHE NË EMËR TË BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM

Aneksi - I Përshkrimi i asetit

Është propozuar që IDB të marrë pjesë në financimin e projektit nëpërmjet Istisna'a për një shumë prej US\$35,174,256.80- (Dollarë Amerikanë – Tridhjetë e Pesë Milionë e Njëqind e Shtatëdhjetë e Katër Mijë e Dyqind e Pesëdhjetë e Gjashtë e Tetëdhjetë Centë). Financimi i IDB-së do të mbulojë sa vijon:

i) Prerja e Mulletit: Pika e Fillimit Progresivi 4+000 km – Pika e Përfundimit Progresivi 5+000 km, Gjatësia 1,000 m

ii) Rrëshqitja e Dheut Ibe: Pika e Fillimit Progresivi 10 + 800 Km - Pika e Përfundimit Progresivi 11+500 km, Gjatësia 700 m

iii) Rrëshqitja e Dheut Progresivi 12+000: Pika e Fillimit Progresivi 11+800 km - Pika e Përfundimit Progresivi 12+400 km, Gjatësia 600 m

iv) Rrëshqitja e Dheut Progresivi 13+000: Pika e Fillimit Progresivi 13+000 - Pika e Përfundimit Progresivi 13+800, Gjatësia 800 m

v) Rrëshqitja e Dheut Progresivi 14+000: Pika e Fillimit Progresivi 14+000 - Pika e Përfundimit Progresivi 14+600, Gjatësia 600 m

Aneksi - II Përshkrimi i projektit

Objektivat kryesore të projektit janë sigurimi i fluksit të pandërprerë të trafikut, reduktimi i kostove operuese të automjeteve, aksidentet e trafikut, kursimi i kohës dhe rritja ekonomike e përgjithshme në zonën e projektit. Projekti gjithashtu do të lejojë akses më të shpejtë në zonat bregdetare dhe në terrenin spektakolar malor dhe në zonën rurale përtej Elbasanit, si dhe do të sigurojë një lidhje të rëndësishme me vendet fqinje Maqedoni dhe Greqi, duke rritur aktivitetet e tregtisë, turizmit e tranzitit në Shqipëri.

Gjatësia e përgjithshme e rrugës është 27 km, nga të cilat do të ndërtohen dy tunele ku secili do të ketë nga dy korsi (gjatësitë mesatare të dy tuneleve janë 2.2 km dhe 2.3 km). Projekti përfshin elementët e mëposhtëm:



1. Punime ndërtimi

Rruga e propozuar përfshin punimet e shtresave të rrugës, tombinot dhe mbrojtjen e shtresave të rrugës, punimet e betonit, mbrojtjen e skarpateve, punimet e urave, sinjalistikën rrugore horizontale dhe vertikale.

2. Shërbimet e Konsulencës

Këto përfshijnë shqyrtimin e projektit të detajuar, asistencë në Agjencinë e Zbatimit gjatë procesit të tenderimit për përzgjedhjen e Kontraktuesit të punimeve të ndërtimit dhe mbikëqyrjen gjatë ndërtimit.

3. Njësia e Menaxhimit të Projektit

Për të ndjekur zbatimin e Projektit do të krijohet një Njësi e re për Menaxhimin e Projektit. Njësia e Menaxhimit të Projektit do të përbëhet nga: drejtori, specialisti i prokurimit, tre inxhinierë kantieri, financier/ekonomist, sekretar/përkthyes,

dy shoferë, pajisje dhe mobilje/pajisje zyre dhe dy automjete 4x4. Njësia e Menaxhimit të Projektit do të ketë për detyrë të: (i) përgatisë të gjithë procesin e prokurimit për përzgjedhjen e konsulentëve dhe të Kontraktuesve sipas udhëzimeve dhe procedurave të IDB-së; (ii) financën e projektit dhe aspektet administrative duke përfshirë menaxhimin e kontratës dhe disbursimet; (iii) vlerësimin, monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e përgjithshëm të projektit.

4. Auditimi

Një kompani audituese me reputacion e përzgjedhur nga Blerësi me miratimin e IDB-së do të ndërmarrë auditimin financiar vjetor të projektit dhe do t'i paraqesë raportet IDB-së.

Plani i propozuar për financimin e projektit jepet në tabelën më poshtë:

Plani i Propozuar i Financimit (US\$)

Komponentët e Projektit	Financimi i IDB-së	Financimi i Abu Dabi-t	Kontributi i Qeverisë Shqipërisë	Financimi OFID (OPEC)	Shuma Përgjithshme
Blerje (Përvetësim) Toke	-	-	4,100,000.00	-	4,100,000.00
Punime Ndërtimi					
Seksioni 1 (Rruga: Tiranë-Tunel-13 km)	106,260,247.52	30,657,034.16	-	-	136,917,281.68
Seksioni 2 (Tunel - 2.2 km)	84,683,881.98	-	-	-	84,683,881.98
Seksioni 3 (Rruga: Tunel-Elbasan-11.8 km)	56,250,047.91	16,025,621.59	-	20,056,911.37	92,332,580.87
Nëntotal-1	247,194,177.41	46,682,655.75	-	20,056,911.37	313,933,744.53
Shërbime Konsulence					
Studimi i Fizibilitetit & Projekti i detajuar	-	-	2,900,000.00	-	2,900,000.00
Seksioni 1 (Mbikëqyrja)	3,191,541.81	2,096,871.19	-	-	5,288,413.00
Seksioni 2 (Mbikëqyrja)	2,156,740.20	-	-	-	2,156,740.20
Seksioni 3 (Mbikëqyrja)	1,280,628.58	1,220,473.06	-	-	2,501,101.64
Nëntotal -2	6,628,910.59	3,317,344.25	2,900,000.00	-	12,846,254.84
Njësia e Menaxhimit të Projektit (PMU)	931,900.00	-	-	-	931,900.00
Auditim Financiar	58,695.00	-	-	-	58,695.00
Nëntotal -3	990,595.00	-	-	-	990,595.00
TOTAL	254,813,683.00	50,000,000.00	7,000,000.00	20,056,911.37	331,870,594.37
Fondi Rezervë (10%)	3,060,573.80	-	-	343,088.63	3,403,662.43
SHUMA PËRGJITHSHME	257,874,256.80	50,000,000.00	7,000,000.00	20,400,000.00	335,274,256.80
Përqindja (%)	76.91	14.91	2.09	6.08	100.00

¹ Diferenca ndërmjet këtij totali dhe shumës së miratuar nga Banka më datën 26/0/2011G përfaqëson shumën e financimit shtesë.



LIGJ
Nr. 50/2017

**PËR MIRATIMIN E REZOLUTËS NR.
BG/6-434, “NË LIDHJE ME RRIJTJEN E
PËRGJITHSHME TË 5-TË TË KAPITALIT
TË BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM
(IDB) DHE ARKËTIMIN E 50 PËR QIND
(PJESA E ARKËTUESHME E PARAVE) TË
KAPITALIT TË NËNSHKRUAR TË
BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM,
SIPAS RRIJTJES SË 4-TË
PËRGJITHSHME TË KAPITALIT DHE
DISA NËNSHKRIMEVE TË TJERA TË
VEÇANTA”, TË VITIT 2013, TË BORDIT
TË GUVERNATORËVE TË BANKËS
ISLAMIKE PËR ZHVILLIM**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet rezoluta nr. BG/6-434, “Në lidhje me rritjen e përgjithshme të 5-të të kapitalit të Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) dhe arkëtimin e 50 për qind (pjesa e arkëtueshme e parave) të kapitalit të nënshkruar të Bankës Islamike për Zhvillim, sipas rritjes së 4-t të përgjithshme të kapitalit dhe disa nënshkrimeve të tjera të veçanta”, të vitit 2013, të Bordit të Guvernatorëve të Bankës Islamike për Zhvillim, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Pagesa prej 2,13 milionë ID të paguhet me këste të barabarta, përgjatë një periudhe 20-vjeçare, 2016-2035, me një kosto vjetore për Buxhetin e Shtetit prej 106 500 (njëqind e gjashtë mijë e pesëqind) ID, në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës të specifikuara në rezolutë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.4.2017

Faqe | 5356

**Shpallur me dekretin nr. 10220, datë 27.4.2017
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

BANKA ISLAMIKE
PËR ZHVILLIM
JEDDAH

LOGO

Shkrim Arabisht

ARABIA SAUDITE
Shkrim Arabisht
SË BASHKU
NDERTOJMË NJË TË
ARDHME MË TË MIRË
Shkrim Frëngjisht
DORAZH

Shkrim Arabisht

Ref: CTY/RD2/1526

Shkrim Arabisht
8 maj 2016

Zyrës së:

Shkëlqesisë së Tij Z. Erjon Luci
Zëvendësministër i Financave
(Guvernator i BIZH-it)
Ministria e Financave,
Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nr. 3
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Faks: +355-4-222-8405

Lënda: **Vendim i Bordit të Guvernatorëve të BIZH-it, Nr. BG/6-434 në lidhje me Rritjen e 5^{të} të Përgjithshme të Kapitalit të Bankës Islamike për Zhvillim dhe marrjen e 50% (përqindje cash që mund të merret) të kapitalit të regjistruar të IBZH-së sipas Rritjes së 4^{të} të Përgjithshme dhe disa regjistrimeve të tjera të veçanta.**

Ju lutem gjeni bashkëlidhur kopjen origjinale të Vendimit të Bordit të Guvernatorëve të BIZH-it, Nr. BG/6-434 në lidhje me Rritjen e 5^{të} të Përgjithshme të Kapitalit të Bankës Islamike për Zhvillim dhe marrjen e 50% (pjesë cash që mund të merret) të kapitalit të regjistruar të BIZH-it sipas Rritjes së 4^{të} të Përgjithshme dhe disa regjistrimeve të tjera të veçanta, siç është kërkuar,

Me respekt.

(nënshkrimi)

Elwalid Hamour

Menaxher Divizioni (Azia Qendrore dhe Europa)

Departamenti i Programeve të Vendit

Bashkëlidhur: **Dokumenti Original.**



Në vëmendje të: Znj. Irena Mone Rista, Përgjegjëse e TSA, Financimi i Fondeve të Veçanta dhe të Huaja, Drejtoria e Operacioneve të Thesarit, Ministria e Financave, Republika e Shqipërisë.

MBRETËRIA E ARABISË SAUDITE	(Shkrim Arabisht)	ROY AUME D' ARABIE SAUDITE
P.O.Box 5925, JEDDAH – 21432		B.P. 5925, DJEDDAH - 21432
KABILLO: BANKISLAMI JEDDAH - TELEKS 601137 ISOB SJ		ADRESA TELEGRAFIKE: BANKISLAMI - DJEDDAH TELEKS: 601137ISDB SJ
TEL: 636-1400- FAKS: 6366871		TEL: 6361400 – FAKS: 6366871

REZOLUTA Nr. BG/6-434

Në lidhje me Rritjen e Përgjithshme të 5-të në Kapitalin e Bankës Islamike për Zhvillim dhe Arkëtimin e 50% (pjesa e arkëtueshme e parave) të kapitalit të nënshkruar të BIZH-it sipas Rritjes së Përgjithshme të Kapitalit dhe disa nënshkrimeve të tjera të veçanta

(Miratuar në Seancën Plenare të Mbledhjes Vjetore të tridhjetë e tetë të mbajtur në Dushanbe, Republika e Tashikistanit më 12 Rajab 1434H që përputhet me 22 maj 2013).

BORDI I GUVERNATORËVE

REFERUAR Direktivës së Seksionit të Tretë të Jashtëzakonshëm të Konferencës së Samitit Islamik të mbajtur në Makkah Al-Mukarramah më 7–8 dhjetor 2005 që kërkon një rritje thelbësore të Kapitalit të Bankës Islamike për Zhvillim, me qëllim që t'i mundësohet forcimi i rolit në dhënien e mbështetjes financiare dhe asistencës teknike Vendeve të saj Anëtare; dhe

NË PËRGJIGJE të Direktivës në Komunikatën Përfundimtare të miratuar nga Sesioni i Katërt i Jashtëzakonshëm i Konferencës së Samitit Islamik të mbajtur në Makkah Al-Mukarramah më 14 – 15 gusht 2012 që kërkon një rritje të Kapitalit të BIZH-it për t'i mundësuar asaj të përmbushë nevojat e Vendeve Anëtare dhe duke riafirmuar rolin thelbësor të sektorit privat në zhvillim;

DUKE PASUR PARASYSH:

1) Raportin dhe Rekomandimet e Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të BIZH-it që gjenden në dokumentin Nr. BED/BG/7-434;

2) Rezolutat e Bordit të Guvernatorëve:

a) Nr. BG/6-427 në lidhje me Rritjen e 4-rt të Përgjithshme të Kapitalit të BIZH-it dhe Kërkimin e 70% të Kapitalit të Kërkueshëm sipas Rritjes së 2-të të Përgjithshme të Kapitalit;

b) Nr. BG/11-429 në lidhje me Rritjen e Nënshkrimit të Vendeve Anëtare në Kapitalin e BIZH-it;

c) Nr. BG/9-429 në lidhje me Rritjen e Nënshkrimit të Shtetit të Katarit në Kapitalin e BIZH-it;

d) Nr. BG/4-431 në lidhje me Rritjen e Nënshkrimit të Republikës Federale të Nigerisë në Kapitalin e BIZH-it;

3) Nenet 4, 5(4), 5(6), 7, 21 dhe 29 të Neneve të Marrëveshjes së BIZH-it;

Duke pasur parasysh që periudha pesë (5) vjeçare e parashikuar në Rezolutën Nr. BG/6-427 pas së cilës mund të kërkohej pjesa e kërkueshme në para e Kapitalit të Nënshkruar të BIZH-it sipas Rritjes së 4-rt të Përgjithshme të Kapitalit të Nënshkruar, ka skaduar më 31 maj 2011;

Duke ditur nevojën për rritjen e përgjithshme të Kapitalit të Autorizuar dhe të Nënshkruar të BIZH-IT-së, dhe për kërkimin e pjesës së kërkueshme të Rritjes së 4-rt të Përgjithshme të Kapitalit si dhe shumave të tjera të nënshkruara të Kapitalit të Nënshkruar të BIZH-IT-së;

VENDOSI:

Së pari: Kapitali i Autorizuar dhe Kapitali i Nënshkruar i BIZH-IT-së do të rriten si më poshtë:

1- Kapitali i Autorizuar i BIZH-IT-së rritet me shtatëdhjetë miliard Dinarë Islamikë (ID 70,000,000,000) dhe bëhet njëqind miliardë Dinarë Islamikë (ID 100,000,000,000). Kjo rritje ndahet në shtatë milionë (7,000,000) aksione, ku secili prej tyre ka një vlerë nominale prej dhjetë mijë (10,000) Dinarë Islamikë.

2- Kapitali i Nënshkruar i BIZH-IT-së rritet me tridhjetë e dy miliardë Dinarë Islamikë (ID 32,000,000,000) dhe bëhet pesëdhjetë miliardë Dinarë Islamikë (ID 50,000,000,000). Kjo rritje do të ndahet në tre milionë e dyqind mijë (3,200,000) aksione, ku secili prej tyre ka një vlerë nominale prej dhjetë mijë (10,000) Dinarë Islamikë.

3- Tridhjetë e dy miliardë Dinarë Islamikë (ID 32,000,000,000) të rritjes në Kapitalin e Nënshkruar të BIZH-IT-së, siç përmendet në nën-



paragrafin 2 të këtij paragrafi **të parë**, do të jenë të disponueshëm për nënshkrim nga Vende Anëtare sipas termave dhe kushteve të mëposhtme:

a) Çdo Shtet Anëtar ka të drejtë të nënshkruajë një pjesë të rritjes së Kapitalit të Nënshkruar të BIZH-IT-së, të specifikuar në këtë nën-paragraf 3 të këtij paragrafi **të parë**, të barabartë me raportin që gjendja e tij e nënshkruar deri tani ka me Kapitalin faktik të Nënshkruar menjëherë para datës së kësaj Rezolute.

b) Çmimi i nënshkrimit për aksion është dhjetë mijë Dinarë Islamikë (ID 10,000).

c) Rritja e Kapitalit të Nënshkruar e specifikuar në nën-paragrafin 3 të këtij paragrafi **të parë** nuk do të kërkohet, përveç kur BIZH-it nuk do të jetë e aftë të përmbushë detyrimet e saj. Kërkimi, sipas rastit, do të bëhet në një monedhë lirisht të konvertueshme të pranueshme për BIZH-in dhe është uniforme në përqindje për të gjitha aksionet e kërkueshme.

d) Një Vend Anëtar që nënshkruan rritjen e parashikuar në nën-paragrafin 3 të këtij paragrafi **të parë**, ka një votë për çdo aksion të nënshkruar.

Së dyti:

1- Do të kërkohet një shumë e përgjithshme Dinarësh Islamikë prej tre miliardë e gjashtëqind e njëzet e tetë milionë e katërqind e dyzet mijë, të ndarë si më poshtë:

a) Shuma e nënshkruar e Dinarëve Islamikë prej dy miliardë, nëntëqind e dyzet e pesë milionë, treqind e tridhjetë mijë (ID 2,945,330,000) nga Pesëdhjetë për qind (50%) e rritjes së Kapitalit të Nënshkruar të BIZH-it, sipas Rritjes së 4-rt të Përgjithshme të Kapitalit që bëhet tre miliardë e katërqind e pesëdhjetë milionë Dinarë Islamikë (ID 3,450,000,000).

b) Shuma e nënshkruar e Dinarëve Islamikë prej pesëqind e dyzet e nëntë milionë e shtatëdhjetë mijë (ID 549,070,000) që përfaqësojnë nënshkrimet shtesë të Katarit në pajtim me Rezolutën Nr. BG/9-429 dhe Nigerisë në pajtim me Rezolutën Nr. BG/4-431.

c) Shuma e nënshkruar e Dinarëve Islamikë prej njëqind e tridhjetë e katër milionë e dyzet mijë (ID 134,040,000) që përfaqëson nënshkrimet shtesë të Beninit, Iranit, Jordanit, Libisë, Arabisë Saudite, Senegalit, Sudanit dhe EBA-së që sipas Rezolutës Nr. BG/11-429, për të mbajtur përqindjet përkatëse që mbizotëronin para rritjes së nënshkrimit të Katarit në Kapitalin e BIZH-it.

2- Çdo Shtet Anëtar që ka nënshkruar aksionet e përfaqësuara nga një prej shumave të përmendura në nën-paragrafin 1 të këtij paragrafi **të dytë** do të paguajë vlerën e aksioneve që ka nënshkruar brenda një periudhe prej njëzet (20) vjetësh në dyzet (40) këste të barabarta gjashtë-mujore, duke filluar nga data 01/01/2016.

Së treti:

1- Çdo Vend Anëtar që nuk ka nënshkruar Rritjen e 4-rt të Përgjithshme, në pajtim me paragrafin **e katërt** të këtushëm, mund të nënshkruajë një numër aksionesh të Kapitalit të Nënshkruar të barabartë me numrin e aksioneve të Kapitalit të Nënshkruar të barabartë me numrin e aksioneve që ai ka pasur të drejtë të nënshkruajë në pajtim me Rezolutën Nr. BG/6-427 në lidhje me Rritjen e 4-rt të Përgjithshme të Kapitalit.

2- Çmimi i nënshkrimit për aksion është dhjetë mijë Dinarë Islamikë (ID 10,000).

3- Nënshkrimi, në pajtim me këtë paragraf **të tretë**, bëhet në pajtim me sa më poshtë:

a) Çdo Shtet Anëtar që nënshkruan aksionet e përmendura në këtë paragraf **të tretë** paguan vlerën e aksioneve që përfaqësojnë pjesën e kërkueshme në para të aksioneve që ka nënshkruar (50% e nënshkrimit të tij si më poshtë), brenda një periudhe prej njëzet (20) vjetësh në dyzet (40) këste të barabarta gjashtë-mujore, duke filluar nga data 1/1/2016.

b) Vlera e aksioneve që përfaqësojnë pjesën e kërkueshme të nënshkrimeve sipas këtij paragrafi **të tretë** (50% e këtij nënshkrimi të plotë) nuk kërkohet, përveç kur BIZH-i nuk është e aftë të përmbushë detyrimet e saj. Kërkimet, sipas rastit, bëhen në një monedhë lirisht të këmbyeshme, të pranueshme për BIZH-in dhe është e njëtrajtshme në përqindje për të gjitha aksionet e kërkueshme.

4- Një Vend Anëtar që nënshkruan aksione në pajtim me këtë paragraf **të tretë**, ka një votë për çdo aksion të paguar dhe ka një votë për çdo aksion që përfaqëson pjesën e kërkueshme të nënshkrimit të tij.

5- Kapitali i Nënshkruar i BIZH-it rritet automatikisht me qëllim që të rregullojë nënshkrimet e Vendeve Anëtare që nuk kanë nënshkruar Rritjen e 4-rt të Përgjithshme të Kapitalit të BIZH-it.

Së katërti: Çdo Vend Anëtar që ka vullnetin të nënshkruajë aksione të disponueshme për nënshkrim në pajtim me këtë Rezolutë:



1- Jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga data e kësaj Rezolute, njofton zyrtarisht BIZH-in që ai dëshiron të nënshkruajë; me kusht që Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë të mund të lejojë afate të mëtejshme për një njoftim të tillë. Në mungesë të këtij njoftimi nga një Vend Anëtar pas periudhës së specifikuar këtu ose pas çdo zgjatjeje të saj, ky Vend Anëtar konsiderohet të ketë hequr dorë nga e drejta e tij për të nënshkruar aksionet e disponueshme për nënshkrimin e tij. Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë i rekomandon Bordit të Guvernatorëve mënyrat dhe mjetet e trajtimit të aksioneve që mbeten të panënshkruara pas periudhës së specifikuar këtu ose pas çdo zgjatjeje të saj që Bordi i Drejtorëve Ekzekutivë mund të ketë vendosur.

2- Përfaqëson para BIZH-it që ai ka ndërmarrë

të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar këtë nënshkrim dhe t'i japë BIZH-it çdo informacion për këtë që mund të kërkojë BIZH-i.

Së pesti: Në pajtim me dispozitat e kësaj Rezolute, Nenet e Marrëveshjes së BIZH-it zbatohen për të gjitha aksionet e nënshkruara dhe pagesat e kryera ose që do të kryhen nga vendet Anëtare sipas kësaj Rezolute.

NXIT të gjitha Vendet Anëtare për të paguar vlerën e aksioneve që kanë nënshkruar në pajtim me këtë Rezolutë ose një Rezolutë tjetër, në pajtim me termat dhe kushtet e Rezolutës përkatëse.

Tabelë shpjeguese për paragrafin e parë të Rezolutës nr. BG/6-434 më 5 GCI

Tabela 1 – Caktimi i 5 GCI bazuar në kapitalin faktik të nënshkruar të BIZH-it

Alokimi i 5 GCI

Vendi	Nr. i aksioneve	Totali (mil ID)	% i Alokimit bazuar në Kapitalin e dhënë/nënshkruar ¹	Nr. i aksioneve ²	Në mil ID
01. Afganistan	993	9.930	0.06%	1.787.0	17.870
02. Shqipëri	923	9.230	0.05%	1.661.0	16.610
03. Algjeri	45.922	459.220	2.58%	82.637.0	826.370
04. Azerbajxhan	1.819	18.190	0.10%	3.273.0	32.730
05. Bahrein	2.588	25.880	0.15%	4.657.0	46.570
06. Bangladesh	18.216	182.160	1.02%	32.78.0	320.780
07. Benin	2.080	20.800	0.12%	3.743.0	37.430
08. Brunei	4.585	45.850	0.26%	8.251.0	82.510
09. Burkina Faso	2.463	24.630	0.14%	4.432.0	44.320
10. Kamerun	4.585	45.850	0.26%	8.251.0	82.510
11. Çad	977	9.770	0.05%	1.758.0	17.580
12. Komoros	465	4.650	0.03%	837.0	8.370
13. Bregu i Fildishtë	465	4.650	0.03%	837.0	8.370
14. Xhibut	496	4.960	0.03%	893.0	8.930
15. Egjipt	127.867	1.278.670	7.19%	230.098.0	2.300.980
16. Gabon	5.458	54.580	0.31%	9.822.0	98.220
17. Gambia	923	9.230	0.05%	1.661.0	16.610
18. Guinea	4.585	45.850	0.26%	8.251.0	82.510
19. Guinea-Bisao	496	4.960	0.03%	893.0	8.930
20. Indonezi	40.648	406.480	2.29%	73.147	731.470
21. Iran	149.120	1.491.200	8.39%	268.343.0	2.683.430
22. Irak	4.824	48.240	0.27%	8.681.0	86.810
23. Jordan	7.850	78.500	0.44%	14.126.0	141.260
24. Kazakistan	1.929	19.290	0.11%	3.471.0	34.710
25. Kuvait	98.588	985.880	5.54%	177.410.0	1.774.100
26. Rep. e Kirkizit	923	9.230	0.05%	1.661.0	16.610
27. Liban	977	9.770	0.05%	1.758.0	17.580
28. Libi	170.446	1.704.460	9.58%	306.720.0	3.067.200
29. Malajzi	29.401	294.010	1.65%	52.907.0	529.070
30. Maldive	923	9.230	0.05%	1.661.0	16.610
31. Mali	1.819	18.190	0.10%	3.273.0	32.730
32. Mauritani	977	9.770	0.05%	1.758.0	17.580
33. Marok	9.169	91.690	0.52%	16.500.0	165.000
34. Mozambik	923	9.230	0.05%	4.661.0	46.610

¹ Alokimi i përshtatur për shpërndarjen e aksioneve shtesë

² Rumbullakimi tek shifra më e afërt e madhe/e vogël dhjetore



35.Niger	2.463	24.630	0.14%	4.432.0	44.320
36.Nigeri	138.400	1.384.000	7.78%	249.052.0	2.490.520
37.Oman	5.092	50.920	0.29%	9.163.0	91.630
38.Pakistan	45.922	459.220	2.58%	82.637.0	826.370
39.Palestinë	1.955	19.550	0.11%	3.518.0	35.180
40.Katar	129.750	1.297.500	7.30%	233.486.0	2.334.860
41.Arabi Saudite	424.960	4.249.600	23.90%	764.720.0	7.647.200
42.Senegal	5.280	52.800	0.30%	9.501	95.010
43.Sierra Leone	496	4.960	0.03%	893.0	8.930
44.Somali	496	4.960	0.03%	893.0	8.930
45.Sudan	8.321	83.210	0.47%	14.974.0	140.940
46.Surinam	923	9.230	0.05%	1.661.0	16.610
47.Siri	1.849	18.490	0.10%	3.327.0	33.270
48.Txhikistan	496	4.960	0.03%	893.0	8.930
49.Togo	496	4.960	0.03%	893.0	8.930
50.Tunizi	1.955	19.550	0.11%	3.518.0	35.180
51.Turqi	116.586	1.165.860	6.56%	209.798.0	2.097.980
52.Turkmekistan	496	4.960	0.03%	893.0	8.930
53.Emiratet e Bashkuara Arabe	135.720	1.357.200	7.63%	244.229.0	2.442.290
54.Uganda	2.463	24.630	0.14%	4.432.0	44.320
55.Uzbekistan	480	4.800	0.03%	864.0	8.640
56.Jemen	9.238	92.380	0.52%	16.624.0	166.240
Mungesa/ (Mbipagesa), Neto	*	*	*	-	-
Nëntotali	1.778.260	17.782.600	100.00%	3.200.000.0	32.000.00
E paangazhuar	21.740	217.400	0.00%	-	-
Totali i përgjithshëm	1.800.000	18.000.000	100.00%	3.200.000.0	32.000.000

Tabelë shpjeguese për paragrafin e dytë të Rezolutës nr BG/6-434 për arkëtimin e 50% të GCI-së 4-ët (pjesa e arkëtueshme në para)

Tabela 2 – Gjendja e konsoliduar e detajuar & shumat e kësteve bazuar në GCI—në fillestare 4, për të marrë Bed Seat & Mbajtur përqindjen para Katarit

SHUMA NË MILIONË ID

Nr.	Shteti	100% e GCI-së së përgjithshme	Pjesa e konsoliduar e arkëtueshme në para- transhi B (50%)			Pjesa e arkëtueshme në para (a+b+c)	Nr. i aksioneve	Kësti gjysmë-vjetor për 20 vjet	Kësti vjetor për 20 vjet	Totali i kësteve për 20 vjet
			(a) GCI-ia fillestare 4	(b) BED seat – Rritja e nënshkrimit në Katar dhe Nigeri	(c) Rritja për të ruajtur nivelin e aksioneve të para-Katarit					
1	Afganistan	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Shqipëri	4.270	2.130	-	-	2.130	213	0.053	0.107	2.130
3	Algjeri	212.550	106.270	-	-	106.270	10.627	2.657	5.314	106.270
4	Azerbajxhan	8.420	4.210	-	-	4.210	421	0.105	0.211	4.210
5	Bahrejn	11.980	5.990	-	-	5.990	599	0.150	0.300	5.990
6	Bangladesh	84.310	42.150	-	-	42.150	4.215	1.054	2.108	42.150
7	Benin	8.830	4.210	-	0.195	4.405	441	0.110	0.220	4.405
8	Brunei	21.220	10.610	-	-	10.610	1.061	0.265	0.531	10.610
9	Burkina Faso	-	-	-	-	-	-	-	-	-
10	Kamerun	21.220	10.610	-	-	10.610	1.061	0.265	0.531	10.610
11	Çad	-	-	-	-	-	-	-	-	-
12	Kamoro	2.150	1.070	-	-	1.070	107	0.027	0.054	1.070
13	Bregu i Fildishtë	2.150	1.070	-	-	1.070	107	0.027	0.054	1.070
14	Xhibut	-	-	-	-	-	-	-	-	-
15	Egjipt	591.830	295.910	-	-	295.910	29.591	7.398	14.796	295.910
16	Gabon	25.260	12.630	-	-	12.630	1.263	0.316	0.632	12.630
17	Gambia	4.270	2.130	-	-	2.130	213	0.053	0.107	2.130
18	Guinea	21.220	10.610	-	-	10.610	1.061	0.265	0.531	10.610
19	Guinea-Bisao	-	-	-	-	-	-	-	-	-
20	Indonezi	159.810	79.900	-	-	79.900	7.990	1.998	3.995	79.900
21	Iran	633.160	299.310	-	17.270	316.580	31.658	7.915	15.829	316.580
22	Irak	22.330	11.160	-	-	11.160	1.116	0.279	0.558	11.160
23	Jordan	33.330	16.660	-	-	16.660	1.666	0.417	0.833	16.660
24	Kazakistan	8.930	4.470	-	-	4.470	447	0.112	0.224	4.470
25	Kuvajt	-	-	-	-	-	-	-	-	-
26	Rep. e Kirkizit	4.270	2.130	-	-	2.130	213	0.053	0.107	2.130
27	Liban	-	-	-	-	-	-	-	-	-
28	Libi	723.710	342.100	-	19.745	361.845	36.185	9.046	18.092	361.845
29	Malaji	136.080	68.040	-	-	68.040	6.804	1.701	3.402	68.040



30	Maldivë	4.270	2.130	-	-	2.130	213	0.053	0.107	2.130
31	Mali	8.420	4.210	-	-	4.210	421	0.105	0.211	4.210
32	Mauritani	-	-	-	-	-	-	-	-	-
33	Marok	42.440	21.220	-	-	21.220	2.122	0.531	1.061	21.220
34	Mozambik	4.270	2.130	-	-	2.130	213	0.053	0.107	2.130
35	Niger	-	-	-	-	-	-	-	-	-
36	Nigeri	587.650	1.070	292.750	-	293.820	29.382	7.346	14.691	293.820
37	Oman	32.570	11.780	-	-	11.780	1.178	0.295	0.589	11.780
38	Pakistan	212.550	106.280	-	-	106.280	10.628	2.657	5.314	106.280
39	Palestinë	-	-	-	-	-	-	-	-	-
40	Katar	596.850	42.110	256.320	-	298.430	29.843	7.461	14.922	298.430
41	Arabi Saudite	1,804.380	852.830	-	49.360	902.190	90.219	22.555	45.110	902.190
42	Senegal	22.420	10.620	-	0.590	11.210	1.121	0.280	0.561	11.210
43	Sierra Leone	-	-	-	-	-	-	-	-	-
44	Somali	-	-	-	-	-	-	-	-	-
45	Sudan	35.330	16.840	-	0.815	17.655	1.766	0.441	0.883	17.655
46	Surinam	4.270	2.130	-	-	2.130	213	0.053	0.107	2.130
47	Siri	8.560	4.280	-	-	4.280	428	0.107	0.214	4.280
48	Taxhikistan	-	-	-	-	-	-	-	-	-
49	Togo	-	-	-	-	-	-	-	-	-
50	Tunizi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
51	Turqi	539.620	269.810	-	-	269.810	26.981	6.745	13.491	269.810
52	Turkmenistan	-	-	-	-	-	-	-	-	-
53	Emiratet e Bashkuara Arabe	576.270	242.060	-	46.065	288.125	28.813	7.203	14.406	288.125
54	Uganda	-	-	-	-	-	-	-	-	-
55	Uzbekistan	2.150	1.080	-	-	1.080	108	0.027	0.054	10.080
56	Jemen	42.760	21.380	-	-	21.380	2.138	0.535	1.069	21.380
Total		7,257.080	2,945.330	549.070	134.040	3,628.440	362,844	90.711	181.422	3,628.440

Tabelë shpjeguese për paragrafin e tretë të rezolutës nr BG/6-434 për arkëtimin e 50% të GCI-së 4 (pjesa e arkëtueshme në para)

Tabela 3 – Vendet Anëtare që duhet të nënshkruajnë GCI-në e 4 dhe këstet e tyre të parashikuara nëse vendosin të nënshkruajnë

Totali i Alokimit Fillestar GCI 4 6,900.000

SHUMA NË MILION ID

Vendet në Pritje të Nënshkrimit

Nr.							
1	Burkina Faso	21.220	0.308%	10.610	0.265	0.531	10.610
2	Çad	8.420	0.122%	4.210	0.105	0.211	4.210
3	Xhibut	4.270	0.062%	2.135	0.053	0.107	2.135
4	Guinea-Bisao	4.270	0.062%	2.135	0.053	0.107	2.135
5	Kuvajt	849.510	12.321%	424.755	10.619	21.238	424.755
6	Liban	8.420	0.122%	4.210	0.105	0.211	4.210
7	Mauritani	8.420	0.122%	4.210	0.105	0.211	4.210
8	Niger	21.220	0.308%	10.610	0.265	0.531	10.610
9	Palestinë	16.850	0.244%	8.425	0.211	0.421	8.425
10	Sierra Leone	4.270	0.062%	2.135	0.053	0.107	2.135
11	Somali	4.270	0.062%	2.135	0.053	0.107	2.135
12	Taxhikistan	4.270	0.062%	2.135	0.053	0.107	2.135
13	Togo	4.270	0.062%	2.135	0.053	0.107	2.135
14	Tunizi	16.850	0.244%	8.425	0.211	0.421	8.425
15	Turkmenistan	2.150	0.031%	1.075	0.027	0.054	1.075
16	Uganda	21.220	0.308%	10.610	0.265	0.531	10.610
Total		999.900	14.491%	499.950	12.499	24.998	499.950

**BANKA ISLAMIKE PËR ZHVILLIM
JEDDAH – ARABIA SAUDITE**

Hollësi për Llogaritë Bankare të BIZH-it për
Depozitim e Kontributeve për Kapitalin
Aksioner

DOLLARË AMERIKANË

Për: HSBC, New York
(SWIFT: MRMDUS33XXX)
A/C: Gulf International Bank (UK) London
(SWIFT: SINTGB2LXXX)
F/O: Islamic Development Bank

P.O. Box 5925, Jeddah 21432, Kingdom of
Saudi Arabia

Llogaria e Nënshkrimit të Kapitalit Aksioner
Nr. 159112

IBAN: GB09SINT60928000159112

EURO

Për: Deutsche Bank Frankfurt
(SWIFT: DEUTDEFFXXX)
A/C: Gulf International Bank (UK) London
(SWIFT: SINTGB2LXXX)
F/O: Islamic Development Bank
P.O. Box 5925,



Jeddah 21432, Kingdom of Saudi Arabia
Llogaria Nr. 159117
IBAN: GB09SINT60928000159117

GBP

Për: Gulf International Bank (UK) London
(SWIFT: SINTGB2LXXX)
Nëpërmjet kodit të klasifikimit: 60-92-80
F/O: Islamic Development Bank
P.O. Box 5925, Jeddah 21432, Kingdom of Saudi Arabia
Llogaria Nr. 159137
IBAN: GB09SINT60928000159137

LIGJ
Nr. 52/2017

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT NR. 1
TË MARRËVESHJES SË GRANTIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI
ADMINISTRATORE E FONDEVE
GRANT, TË SIGURUARA NGA AGJENCIA
SUEDEZE PËR ZHVILLIMIN E
BASHKËPUNITIT NDËRKOMBËTAR
(SIDA) NËN FONDIN SUEDEZ TË
BESIMIT, PËR FONDIN E BESIMIT NR.
TF072239, PËR PROJEKTIN E
SHËRBIMEVE MJEDISORE NË
SHQIPËRI, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR.64/2015**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:**Neni 1**

Ratifikohet ndryshimi nr. 1 i marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruar nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), nën Fondin Suedez të Besimit, për Fondin

e Besimit nr. TF072239, për projektin e shërbimeve mjedisore në Shqipëri, të ratifikuar me ligjin nr. 64/2015, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.4.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10222, datë 27.4.2017
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

BANKA BOTËRORE

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim

1818H Street N.W
Washington, D.C. 20433 U.S.A

(202) 473-1000
Adresa kablllore : INTBAFRAD
Adresa kablllore: INDEVAS

25 mars 2016

Shkëlqesisë së Tij, Arben Ahmetaj
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi Dëshmorët e Kombit
Tiranë, Shqipëri

Lënda :Projekti i Shërbimeve Mjedisore në
Shqipëri

TF (Fondi i Besimit) Suedez nr. TF018238
Amendamenti nr.1 i Marrëveshjes së Grantit

Shkëlqesi:

I referohemi Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Marrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”), e cila vepron si administratore e fondeve të grantit të ofruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) për projektin e lartpërmendur të datës 10 tetor 2014 (“Marrëveshja”).

Në përputhje me diskutimin e kohëve të fundit ndërmjet Bankës Botërore dhe Marrësit në lidhje me uljen e shumës së Grantit me gjashtëqind e pesëdhjetë mijë Dollarë Amerikanë (\$ 650,000) për të reflektuar zhvlerësimin e SEK (monedha e



kontributit të SIDA-s) ndaj Dollarit të Shteteve të Bashkuara (monedha që mban Granti), Banka Botërore ka rënë dakort që të amendojë Marrëveshjen (Amendamenti) me formulimin e mëposhtëm:

1. Nëpërmjet këtij dokumenti, paragrafi 1 i Marrëveshjes amendohet për të reduktuar shumën e Grantit me formulimin e mëposhtëm:

“Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë në emër të Shqipërisë (“Marrësi”), kam kënaqësinë t’iu informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”) që vepron si administratore e fondeve të grantit të ofruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, SIDA (“Donatori”) sipas Fondit të Besimit Suedeze

për Projektin e Shërbimeve Mjedisore në Shqipëri me Fondin e Besimit nr. TF072239 (Kontributi i SIDA-s nr. 53030017) propozon që t’i japë Marrësit një grant në një shumë e cila nuk tejkalon shtatë milion e treqind e dhjetë mijë Dollarë të Shteteve të Bashkuara (\$7.310,000) (“Granti”) mbi kushtet dhe termat e përcaktuara ose të përmendura në këtë letër marrëveshjeje (“Marrëveshje”), e cila përfshin Shtojcën bashkëlidhur për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në Shtojcë (“Projekti”).”

2. Nëpërmjet këtij dokumenti, tabela në paragrafin 3.0 të Aneksit të Marrëveshjes ndryshohet me formulimin e mëposhtëm:

Shkëlqesia e tij, Arben Ahmetaj 25 mars 2016

Kategoria	Shuma e Grantit të Alokuar (e shprehur në USD)	Përqindja e Shpenzimeve që do të financohen (duke përfshirë taksat)
(1) Mallra, Punime, Shërbime Konsulencë dhe Jo-konsulencë. Trajnime, Kosto operative sipas Pjesës 1, Pjesës 2 (a) dhe (c), Pjesës 3 (a) dhe (c) dhe Pjesës 4 të Projektit.	5,640,000	100%
(2) Nënprojekte sipas Pjesës 2(b) të Projektit	1,670,000	100%
SHUMA TOTALE	7,310,000	

Të gjitha termat dhe kushtet e Marrëveshjes, me përjashtim të amendimeve në këtë dokument, mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutem konfirmoni marrëveshjen e Marrësit me letrën e mësipërme të Amendamentit, duke nënshkruar, vendosur datën dhe duke na kthyer kopjen bashkëlidhur të kësaj letre Amendamenti. Letra e Amendamentit do të hyjë në fuqi në datën kur Banka Botërore i dërgon Marrësit njoftim për marrjen e njoftimit të Marrësit, që ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj letre Amendamenti është autorizuar në mënyrën e duhur ose ratifikuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Me respekt

**BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM**

Nga _____

Tahsenn Sayed

Menaxher Vendi/Shteti

Zyra e Bankës Botërore, Shqipëri

Rënë dakord:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____



LIGJ
Nr. 54/2017

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË
HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM PËR HUAN E
POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË
SEKTORIT FINANCIAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.4.2017

Shpallur me dekretin nr. 10223, datë 27.4.2017
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani

HUA NR. 8698-AL

MARRËVESHJE HUAJE
(HUA PËR POLITIKAT PËR ZHVILLIMIN
E SEKTORIT FINANCIAR) NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Datë 20 mars, 2017

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshje e datës 20 mars, 2017, e lidhur ndërmjet REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (“Huamarrësi”) dhe BANKËS NDËRKOMBË-
Faqe| 5364

TARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (“Banka”), me qëllim vënien në dispozicion të financimit në mbështetje të Programit (siç përcaktohet në Shtojcën e kësaj Marrëveshjeje). Banka ka vendosur ta japë këtë financim, ndër të tjera, në bazë të (i) masave që Huamarrësi ka marrë tashmë në kuadër të Programit dhe të cilat përshkruhen në Seksionin I, shkronja “A” të Skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe (ii) ruajtjes nga Huamarrësi të një kuadri të mjaftueshëm politikash makroekonomike. Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni I

Kushtet e përgjithshme; Përkufizime

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç përkufizohen në Shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Nëse nuk e kërkon ndryshe konteksti, termat që fillojnë me gërmë kapitale në këtë Marrëveshje kanë kuptimin e vendosur për to në Kushtet e Përgjithshme ose në Shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Huaja

2.01 Banka bie dakord t’i japë hua Huamarrësit, sipas kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, shumën prej 100,000,000 USD (njëqind milion dollarë) (“Huaja”).

2.02 Huamarrësi mund t’i tërheqë fondet e Huasë në mbështetje të Programit sipas seksionit II të Skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa e pagueshme në fillim nga Huamarrësi është sa një e katërta e një për qind (0.25%) e shumës së Huasë.

2.04 Tarifa e Angazhimit e pagueshme nga Huamarrësi është sa një e katërta e një për qind (0.25%) në vit e Balancës së Patërhequr të Huasë.

2.05 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo Periudhë Interesi është me një normë të barabartë me Normën Referuese për Monedhën e Huasë plus një Marzh të Pandryshueshëm; megjithatë me kusht që interesi i pagueshëm të mos jetë asnjëherë më pak se zero për qind (0%) në vit. Pavarësisht nga sa më lart, nëse shuma e Balancës së Tërhequr të Huasë mbetet e papaguar kur bëhet e kërkueshme dhe nëse një mospagim i tillë vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh,



atëherë interesi i pagueshëm nga Huamarrësi llogaritet siç parashikohet në Seksionin 3.02 (e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.06 Datat e Pagesës janë 15 mars dhe 15 shtator të çdo viti.

2.07 Principali i Huasë duhet të shlyhet sipas tabelës së amortizimit të përcaktuar në Skedulën 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.08 Pa u kufizuar tek dispozitat e Seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme (rinumërtuar si i tillë në bazë të paragrafit 5 të Seksionit II të Shtojcës së kësaj Marrëveshjeje dhe në lidhje me *Bashkëpunimin dhe Konsultimin*), Huamarrësi i jep menjëherë Bankës informacionet e lidhura me dispozitat e këtij neni II sipas kërkesave të arsyeshme e të herëpashershme të Bankës.

Neni III Programi

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për Programin dhe zbatimin e tij. Për këtë qëllim dhe në vijim të Seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme:

a. Huamarrësi dhe Banka, herë pas here, me kërkesën e secilës palë, shkëmbejnë pikëpamje për kuadrin e politikave makroekonomike të Huamarrësit dhe për progresin e arritur në realizimin e Programit;

b. përpara çdo shkëmbimi të tillë pikëpamjesh, Huamarrësi i jep Bankës për rishikim dhe komente, një raport për progresin e arritur në realizimin e Programit, në detaje të tilla që Banka mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme; dhe

c. pa u kufizuar tek dispozitat e paragrafëve (a) dhe (b) të këtij Seksioni, Huamarrësi e informon menjëherë Bankën për çdo situatë që do të kishte për pasojë kthimin pas, nga pikëpamja materiale, të objektivave të Programit ose për çdo masë të marrë në bazë të Programit, duke përfshirë edhe masat e përcaktuara në Seksionin I të Skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV Mjetet Ligjore të Bankës

4.01 Ngjarja Shtesë e Pezullimit konsiston në rastin kur ka lindur një situatë e cila nuk mundëson realizimin e Programit ose të një pjese të konsiderueshme të tij.

Neni V

Hyrja në fuqi; Zgjidhja

5.01 Kushti Shtesë i Hyrjes në Fuqi konsiston në faktin që Banka të jetë e kënaqur me progresin e arritur nga Huamarrësi në realizimin e Programit dhe me nivelin e mjaftueshëm të kuadrit të politikave makroekonomike të Huamarrësit.

5.02 Afati për Hyrjen në Fuqi është data 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni VI

Përfaqësuesi; Adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i tij i financave.

6.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Nr. 3 Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë, Shqipëri

Faks:

355 42228494

6.03 Adresa e Bankës është:

International Bank for Reconstruction and Development

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Teleks:

248423(MCI) ose

64145(MCI)

Faks:

1-202-477-6391

Rënë dakord në Tiranë, Republika e Shqipërisë, në ditën dhe vitin e shkruar në krye.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: ARBEN AHMETAJ

Titulli: MINISTËR I FINANCave

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR

RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: LADA STRELKOVA

Titulli: ZV/DREJTOR VENDI, ECCWB



SKEDULI 1

Masat e Programit; Disponueshmëria e
Fondeve të Huasë

Seksioni I.

A. Masat e marra në bazë të Programit.

Masat e marra nga Huamarrësi në bazë të Programit përfshijnë sa më poshtë. Huamarrësi ka:

1. Aprovuar fuqizimin e regjimit të paaftësisë paguese, siç dëshmohet nga miratimi i Ligjit për Falimentin nr. 110/2016, i datës 27 tetor 2016, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 226 të datës 22 nëntor 2016.

2. Aprovuar fillimin e reformave të reja në fushën e përmbarimit privat për të përshpejtuar ekzekutimet e kolateralit përmes miratimit të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile (Ligji nr.8116), siç dëshmohet nga miratimi i Ligjit nr. 114/2016 të datës 3 nëntor 2016, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 219 të datës 15 nëntor 2016, dhe Ligjit për Përmbaruesit Privatë (Ligji nr. 10031), siç dëshmohet nga miratimi i Ligjit nr. 109/2016 i datës 27 tetor 2016, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 229 të datës 25 nëntor 2016.

3. Aprovuar përmirësimet e cilësisë së auditimit të Subjekteve me Interes Publik (SIP), nëpërmjet miratimit të ndryshimeve në Ligjin për Auditimin Ligjor (Ligji nr. 10091) që e përafrojnë me legjislacionin e BE-së, siç dëshmohet nga miratimi i Ligjit nr. 47/2016 të botuar në Fletoren Zyrtare nr.84 të datës 19 maj 2016.

4. Aprovuar zgjerimin e mbulimit të sigurimit të depozitave për personat juridikë, nëpërmjet miratimit të ndryshimeve në Ligjin për Sigurimin e Depozitave (Ligji nr. 53/2014), siç dëshmohet nga miratimi i Ligjit nr. 39/2016 të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 77 të datës 9 maj 2016.

5. Aprovuar fuqizimin e kuadrit të zgjidhjes së bankave tregtare në përputhje me Direktivën e BE-së për rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e bankave, siç dëshmohet nga miratimi i Ligjit nr. _____, të datës _____, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. _____, datë _____.

6. Përfunduar, nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, vlerësimin e planeve të rimëkëmbjes sistematike të bankave për vitin 2015, për të mundësuar gatishmëri dhe administrim të efektshëm të krizave, siç dëshmohet nga letra e nënshkruar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë më 15 janar 2016.

7. Aprovuar fuqizimin e rregullimit dhe mbikëqyrjes së Shoqatave të Kursimeve dhe Kredive (SHKK), siç dëshmohet nga miratimi i Ligjit për Shoqatat e Kursimeve dhe Kredive nr. 52/2016, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 107 të datës 15 qershor 2016.

8. Miratuar, nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, rregullore të reja për licencimin, raportimin dhe menaxhimin e riskut për SHKK-të, në mbështetje të një rregullimi dhe mbikëqyrjeje më të fortë të këtij sektori, siç dëshmohet nga miratimi i Vendimeve nr. 104, nr. 105 dhe nr.106 të Bankës së Shqipërisë të datës 5 tetor 2016, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 196 të datës 25 tetor 2016.

9. Miratuar fuqizimin e kompetencave zbatuese të AMF-së përmes miratimit të ndryshimit të Ligjit për Sipërmarrjet e Investimeve të Përbashkëta (Ligji nr. 10 198), siç dëshmohet nga miratimi i Ligjit nr. 36/2016 të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 64 të datës 20 prill 2016.

10. Miratuar, nëpërmjet AMF-së, rregulloret e të reja për menaxhimin e likuiditetit dhe për vlerësimet sipas çmimit të tregut për të ulur rreziqet e mbajtësve të kuotave të fondeve të investimeve, siç dëshmohet nga Vendimet e Bordit të AMF-së nr. 45 dhe 46 të datës 30 qershor 2015, të botuara në faqen e internetit të AMF-së: <http://www.amf.gov.al/buletini.asp?id=20&r=11>.

Seksioni II. Disponueshmëria e Fondeve të Huasë

A. Të përgjithshme. Huamarrësi mund t'i tërheqë fondet e Huasë në përputhje me dispozitat e këtij Seksioni dhe me udhëzime të tjera shtesë që Banka mund t'i njoftojë Huamarrësit.

B. Alokimi i Shumave të Huasë. Huaja (me përjashtim të shumave të kërkuara për të paguar Tarifën e Pagueshme në Fillim) alokohet në një transh të vetëm për tërheqje, nga i cili Huamarrësi mund të kryejë tërheqje të fondeve të Huasë. Alokimi i shumave të Huasë për këtë qëllim përcaktohet në tabelën në vijim:

Alokimet	Shuma e Huasë e Alokuar (shprehur në dollarë amerikanë)
(1) Transh i vetëm për tërheqje	99,750,000
(2) Tarifa e pagueshme në fillim	250,000
SHUMA TOTALE	100,000,000



C. Kushtet për Çlirimin e Transhit për Tërheqje.

Nga Transhi i vetëm për tërheqje nuk kryhet asnjë tërheqje nëse Banka nuk është e kënaqur (a) me realizimin e Programit nga Huamarrësi dhe (b) me mjaftueshmërinë e kuadrit të politikave makroekonomike të Huamarrësit.

D. Depozitat e Shumave të Huasë. Nëse Banka nuk bie dakord ndryshe:

1. Të gjitha shumat e tërhequra nga Llogaria e Huasë Banka i depoziton në një llogari të përcaktuar nga Huamarrësi dhe të pranueshme për Bankën; dhe

2. Huamarrësi siguron që me çdo depozitë të një shume të Huasë në këtë llogari, një shumë e barasvlershme të kontabilizohet në sistemin e menaxhimit të buxhetit të Huamarrësit, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

E. Shpenzimet e Përrjashtuara. Huamarrësi ndërmerr që fondet e Huasë nuk do të përdoren për të financuar Shpenzime të Përrjashtuara. Nëse Banka konstaton në çdo moment se një shumë e Huasë është përdorur për të paguar një Shpenzim të Përrjashtuar, Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit nga Banka, i kthen Bankës një shumë të barasvlershme me një pagesë të tillë. Shumat që i kthehen Bankës me këtë kërkesë, anulohen.

F. Data e Mbylljes. Data e Mbylljes është 31 mars 2018.

SKEDULI 2

Tabela e amortizimit

1. Tabela e mëposhtme përcakton Datat e Pagesës së Principalit të Huasë dhe përqindjen e shumës totale të Principalit të Huasë të pagueshme më çdo Datë Pagesë të Principalit (“Pjesa e Këstit”). Nëse fondet e Huasë janë tërhequr plotësisht nga Data e parë e Pagesës së Principalit, shuma e principalit të Huasë që duhet të shlyejë Huamarrësi në çdo Datë Pagesë të Principalit përcaktohet nga Banka duke shumëzuar: a) Balancën e tërhequr të Huasë deri më datën e parë të Pagesës së Principalit me (b) Pjesën e Këstit për çdo datë të pagesës së Principalit.

Data e Pagesës së Principalit	Pjesa e Këstit (shprehur si përqindje)
Çdo 15 mars dhe 15 shtator Duke filluar nga data 15 mars 2025 deri më 15 shtator 2048	2.08%

2. Nëse fondet e Huasë nuk janë tërhequr plotësisht nga data e parë e Pagesës së Principalit, shuma e principalit të Huasë që duhet të shlyejë Huamarrësi në çdo Datë të Pagesës së Principalit përcaktohet si më poshtë:

(a) Në masën që fondet e Huasë janë tërhequr nga data e parë e Pagesës së Principalit, Huamarrësi shlyen Balancën e tërhequr të Huasë nga kjo datë në përputhje me paragrafin 1 të këtij Skeduli.

(b) Çdo shumë e tërhequr pas Datës së parë të Pagesës së Principalit duhet të shlyhet më çdo Datë të Pagesës së Principalit që bie pas datës së një tërheqjeje të tillë, me një shumë që Banka përcakton duke shumëzuar shumën e çdo tërheqjeje të tillë me një thyesë, numëruesi i të cilës është Pjesa fillestare e Këstit e përcaktuar në tabelën në paragrafin 1 të këtij Skeduli për datën në fjalë të Pagesës së Principalit (“Pjesa Fillestare e Këstit”) dhe emëruesi i të cilës është shuma e të gjitha Pjesëve Fillestare të Këstit të mbetura për Datat e Pagesës së Principalit që bien në këtë datë ose pas kësaj date.

3.(a) Shumat e Huasë të tërhequra brenda dy muajve kalendarikë para çdo Date të Pagesës së Principalit trajtohen vetëm për qëllime të llogaritjes së shumave të principalit të pagueshme më çdo Datë të Pagesës së Principalit, si të tërhequra dhe të pagueshme në Datën e dytë të Pagesës së Principalit pas datës së tërheqjes dhe duhet të shlyhen në çdo Datë të Pagesës së Principalit që fillon me Datën e dytë të Pagesës së Principalit pas datës së tërheqjes.

(b) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi, nëse, në çdo kohë Banka vendos në përdorim një sistem të faturimit me datë shlyerjeje sipas të cilit faturat lëshohen në ose pas Datës përkatëse të Pagesës së Principalit, dispozitat e lartpërmendura nuk zbatohen më tërheqjet e kryera pas vendosjes në përdorim të një sistemi të tillë faturimi.

Seksioni I. Përkufizime

1. “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare” ose “AMF” është agjencia rregullatore financiare e Huamarrësit që është krijuar dhe ushtron aktivitetin në bazë të Ligjit nr. 9572 të datës 03.07.06 ose pasuesi i tij.

2. “BSH” është Banka e Shqipërisë, Banka Qendrore e Huamarrësit që është krijuar dhe ushtron aktivitetin në bazë të Ligjit për Bankën e Shqipërisë nr.8269 të datës 23 dhjetor 1997, ose pasuesi i saj.



3. “Legjislacioni i BE-së” është legjislacioni, aktet ligjore dhe vendimet gjyqësore të akumuluar që përbëjnë korpusin e të drejtës së Bashkimit Evropian.

4. “Shpenzime të përjashtuara” janë çdo shpenzim:

(a) për mallra ose shërbime të furnizuara në bazë të një kontrate që një institucion ose agjenci kombëtare ose ndërkombëtare financimi e ndryshme nga Banka ose Shoqata, ka financuar ose ka rënë dakord t’i financojë, ose të cilën Banka ose Shoqata ka financuar ose ka rënë dakord t’i financojë në kuadër të një huaje, kredie ose granti tjetër;

(b) për mallra të përfshira në grupet ose nëngrupet e mëposhtme të Klasifikimit Tregtar Ndërkombëtar Standard, Rishikimi 3 (SITC, Rev.3), të botuar nga Kombet e Bashkuara në Materialet Statistikore, Seria M, Nr. 34/Rev.3 (1986) (“SITC”), ose në çdo grup ose nëngrup pagues sipas rishikimeve të ardhshme të SITC-së, të cilat Banka ia njofton Huamarrësit:

Grupi	Nëngrupi	Përshkrimi i artikullit
112		Pije alkoolike
121		Duhan, jo i kaluar në prodhim, duhan mbetje
122		Duhan, i kaluar në prodhim (pavarësisht nëse përmban ose jo zëvendësues të duhanit)
525		Lëndë radioaktive dhe lëndë të lidhura
667		Perla, gurë të çmuar dhe gjysmë të çmuar, të përpunuar ose jo të përpunuar
718	718.7	Reaktorë bërthamorë dhe pjesë të tyre; elemente të lëndëve djegëse (fishekë), jo të rrezatuara, për reaktorët bërthamorë
728	728.43	Makineri për përpunimin e duhanit
897	897.3	Bizhuteri me metale të grupit të arit, argjendit ose platinës (me përjashtim të orëve dhe kasave të orëve) dhe mallrat e argjendpuesve dhe argjendpuesve (përfshirë edhe gurët e vendosur në to)
971		Ari, jo monetar (pa përfshirë xehorët dhe koncentratet e arit)

(c) për mallrat e synuara për përdorim ushtarak ose paraushtarak ose për konsum luksi;

(d) për mallrat e rrezikshme për mjedisin, prodhimin, përdorimin ose importimin e të cilave është i ndaluar nga ligjet e Huamarrësit ose nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Huamarrësi është palë;

(e) për llogari të një pagese të ndaluar me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të marrë në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara; dhe

(f) në lidhje me të cilat Banka konstaton se përfaqësues të Huamarrësit ose një përfitues tjetër i fondeve të Huasë janë përfshirë në praktika korruptuese, bashkëpunuese ose shtrënguese për të cilat Huamarrësi (ose një përfitues tjetër i tillë) nuk ka vepruar në kohë dhe siç duhet në mënyrë të kënaqshme për Bankën, për t’u dhënë zgjidhje praktikave të tilla në kohën e ndodhjes së tyre.

5. “Kushtet e përgjithshme” janë “Kushtet e Përgjithshme për Huatë të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim” të datës 12 mars 2012, me ndryshimet e parashikuara në Seksionin II të kësaj Shtojce.

6. “Programi” është programi me masat, objektivat dhe politikat e hartuara për të nxitur rritjen dhe për të arritur ulje të qëndrueshme të varfërisë, dhe të parashikuar ose të përmendur në letrën e datës 14 dhjetor 2016 që Huamarrësi i ka dërguar Bankës, duke deklaruar angazhimin e Huamarrësit për ekzekutimin e Programit dhe duke kërkuar asistencën e Bankës në mbështetje të Programit gjatë ekzekutimit të tij.

7. “SHKK” janë Shoqatat e Kursimeve dhe Kredive që krijohen dhe ushtrojnë aktivitetin në bazë të Ligjit nr. 8782 të datës 5 mars 2001 “Për Shoqatat e Kursimeve dhe Kredive”.

8. “Transhi i Vetëm për Tërheqje” është shuma e Huasë e alokuar për kategorinë me titull “Transhi i Vetëm për Tërheqje” në tabelën e përcaktuar në Pjesën B të Seksionit II të Skedulit 1 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni II. Ndryshime në Kushtet e Përgjithshme

Nëpërmjet këtij seksioni bëhen ndryshimet e mëposhtme në Kushtet e Përgjithshme:

1. Në Tabelën e Lëndës referencat ndaj Seksioneve, titujt e Seksioneve dhe numrat e Seksioneve ndryshohen për të pasqyruar ndryshimet e përcaktuara në paragrafët e mëposhtëm.



2. Fjalja e fundit e paragrafit (a) të Seksionit 2.03 (në lidhje me Kërkesat për Tërheqje) hiqet si e tërë.

3. Seksionet 2.04 (*Llogaritë e përcaktuara*) dhe 2.05 (*Shpenzimet e lejuara*) hiqen në tërësi dhe pjesa e mbetur e seksioneve të nenit II rinumërtohen për të pasqyruar këto ndryshime.

4. Seksioni 3.01 (*Tarifa e pagueshme në fillim*) ndryshon dhe ka përmbajtjen e mëposhtme:

“Seksioni 3.01. *Tarifa e pagueshme në fillim; Tarifa e Angazhimit*

a) Huamarrësi i paguan Bankës një tarifë të pagueshme në fillim mbi shumën e huasë me normën e përcaktuar në Marrëveshjen e Huasë (“Tarifa e pagueshme në fillim”).

b) Huamarrësi i paguan Bankës një tarifë angazhimi mbi Balancën e Patërhequr të Huasë me normën e përcaktuar në Marrëveshjen e Huasë (“Tarifa e Angazhimit”). Tarifa e Angazhimit shtohet nga data që bie gjashtëdhjetë ditë pas datës së Marrëveshjes së Huasë deri në datat përkatëse kur shumat tërhiqen nga Huamarrësi nga Llogaria e Huasë ose kur shumat anulohen. Tarifa e Angazhimit është e pagueshme çdo gjashtë muaj në shumën të prapambetura në çdo Datë Pagese.”

5. Seksionet 5.01 (*Realizimi i Projektit në përgjithësi*) dhe 5.09 (*Drejtimi Financiar; Pasqyrat Financiare; Auditimet*) hiqen në tërësi dhe seksionet e mëposhtme në nenin V rinumërtohen për të pasqyruar këto ndryshime.

6. Paragrafi (a) i Seksionit 5.05 (i rinumërtuar kështu në bazë të paragrafit 5 më lart dhe në lidhje me *Përdorimin e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve*) hiqet si i tërë.

7. Paragrafi (c) i Seksionit 5.06 (i rinumërtuar kështu në bazë të paragrafit 5 më lart) ndryshohet si më poshtë:

“Seksioni 5.06. *Planet; Dokumentet; Evidencat*

...c. Huamarrësi ruan të gjitha Evidencat (kontrata, urdhra, fatura, kambiale, dëftesa dhe dokumente të tjera) që provojnë shpenzimet në kuadër të Huasë deri dy vjet pas Datës së Mbylljes. Huamarrësi u mundëson përfaqësuesve të Bankës t’i shqyrtojnë këto evidenca.”

8. Paragrafi “c” i Seksionit 5.07 (rinumërtuar kështu në bazë të paragrafit 5 më lart) ndryshohet si më poshtë:

“Seksioni 5.07. *Monitorimi dhe Vlerësimi i Programit*

...c. Huamarrësi përgatit, ose siguron që të përgatitet, dhe i vë në dispozicion Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas Datës së Mbylljes, një

raport me objekt dhe në detaje të tilla siç Banka e kërkon në mënyrë të arsyeshme, për realizimin e Programit, përmbushjen nga Palët e Huasë dhe Banka të detyrimeve të tyre përkatëse në bazë të Marrëveshjeve Ligjore dhe përmbushjen e qëllimeve të Huasë.”

9. Në Shtojcë, **Përkufizimet**, të gjitha referencat ndaj numrave të seksioneve dhe paragrafëve ndryshohen, sipas nevojës, për të pasqyruar ndryshimet e përcaktuara më lart.

10. Shtojca ndryshohet duke shtuar një paragraf i ri 19, me përkufizimin e mëposhtëm të “Tarifës së Angazhimit” dhe duke rinumërtuar paragrafët e mbetur për të pasqyruar këto ndryshime:

“19. “Tarifa e angazhimit” është tarifa e angazhimit e përcaktuar në Marrëveshjen e Huasë për qëllim të Seksionit 3.01(b).

11. Paragrafi i rinumërtuar 37 (më parë, paragrafi 36) i Shtojcës (“Shpenzimet e Lejuara”) ndryshohet si më poshtë:

“37. “Shpenzim i lejuar” është çdo përdorim për të cilin Huaja jepet në mbështetje të Programit, që nuk përfshin shpenzimet e financimit të përjashtuara në bazë të Marrëveshjes së Huasë.”

12. Paragrafi 44 i rinumërtuar (më parë, paragrafi 43) i Shtojcës (“Pasqyrat financiare”) hiqet si i tërë.

13. Në paragrafin 48 të Shtojcës, përkufizimi i “Tarifës të pagueshme në fillim” ndryshon duke zëvendësuar referencën ndaj Seksionit 3.01” me Seksionin 3.01(a).

14. Në paragrafin 67 të Shtojcës, përkufizimi i termit “Pagesa e Huasë” ndryshon si vijon:

“67. “Pagesa e Huasë” është çdo shumë e pagueshme nga Palët e Huasë ndaj Bankës në bazë të Marrëveshjeve Ligjore ose këtyre Kushteve të Përgjithshme, duke përfshirë (por pa u kufizuar) çdo shumë të Balancës së tërhequr të Huasë, interesat, Tarifën e pagueshme në fillim, Tarifën e Angazhimit, kamatëvonesën sipas normës së kamatëvonesës (nëse ka), çdo prim parapagimi, tarifë transaksioni për një Konvertim ose zgjidhje përpara afatit të një Konvertimi, Tarifë për Vendosjen e Marzhit të Ndryshueshëm (nëse ka), çdo prim të pagueshëm për vendosjen e një Tavani të Normës së Interesit ose për të vendosur Normë interesi zero dhe çdo Shumë Likuidimi të pagueshme nga Huamarrësi.”

15. Në paragrafin 72 të Shtojcës, përkufizimi i “Datës së Pagesës” ndryshon duke hequr fjalën



“është” dhe duke përfshirë fjalët “dhe Tarifa e angazhimit janë” pas fjalës “interesi”.

16. Termi i përkufizuar “Projekti” në paragrafin 75 të Shtojcës ndryshohet dhe zëvendësohet me fjalën “Programi” dhe përkufizimi i tij ndryshon si vijon (dhe të gjitha referencat ndaj “Projektit” në të

gjithë tekstin e këtyre Kushteve të Përgjithshme konsiderohen të jenë referenca ndaj “Programit”):

“75. “Programi” është programi i përmendur në Marrëveshjen e Huasë në mbështetje të të cilit jepet Huaja.”

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 308 lekë